

## **Bazë e të dhënave për tenderët publik të Komunës së Prishtinës, 2007-2012**

Qendra Kosovare për Gazetari Hulamtuese (QKGH) dhe Organizata ÇOHU! kanë bërë një hulumtim mbi tenderët publik të Komunës së Prishtinës që nga viti 2007 e deri në fillim të vitit 2012, për aq vite aq tenderë sa janë publik në faqen zyrtare në internet të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Në këtë hulumtim janë përfshirë tenderët me vlera të mëdha dhe një pjesë e konsiderueshme e tenderëve me vlerë të mesme, siç i definojnë Ligji i Prokurimit Publik (LPP), ndërsa mungojnë tenderët me vlera të vogla.

Në këtë hulumtim kemi gjetur se Komuna e Prishtinës, në mbi 90 % të rasteve ka lënë pa e plotësuar pjesën ku duhet të shkruhet personi kontaktues. Derisa ky institucion nuk pranon të jap shpjegime pse ka vepruar në këtë mënyrë, duke mos e publikuar një të dhënë e cila është në formularin standard për njoftimin për dhënie të kontratës të miratuar nga KRPP-ja, e të bërë sipas LPP-së, edhe vetë KRPP-ja nuk ka pranuar që të interpretojë në këtë rast nëse institucioni në fjalë, Komuna e Prishtinës, ka bërë shkelje ligjore.

Pa marr parasysh nëse fshehja e personave kontaktues të kompanive të kontraktuara nga Komuna e Prishtinës është shkelje e LPP-së, ky veprim i këtij institucioni, i aplikuar për vite me radhë dhe në mbi 90% të krejt njoftimeve për dhënie të tenderit nga ky institucion, **pamundëson mbikëqyrjen publikut mbi mënyrën shpenzimit të buxhetit komunal nëpërmjet prokurimeve publike.**

Kjo pasi që, siç sugjeron edhe KRPP-ja në përgjigjet e tyre, kërkimi i kompanisë vetëm me emrin e saj në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), qon në një rezultat, që në rastet më të mira mund të **jenë deri në 10 kompani “të dyshuara” si përfituese të tenderit.** Në disa raste, të dhënat që i ka publikuar Komuna e Prishtinës për një kompani, kontraktore në tenderë publik, janë aq të pakta: vetëm emri i kompanisë, dhe kërkimi me to, të qon në një rezultat: **mbi 50 kompani me të njëjtin emër, me veprimtari të licencuara të ngjashme dhe që potencialisht mund të jenë fituesit e tenderit.**

Më poshtë, në këtë bazë të të dhënave, do të shkruajmë veç e veç për secilën kompani, pronarët e të cilës ka qenë e pamundur të identifikohen, kështu që edhe lajthitjet eventuale mund të jenë evidente:

1. **“A Design”**, pronë e Bujar Demjahës, që nga Komuna e Prishtinës ka marr 320 mije euro. Këtë tender e ka përfituar në konzorcium me kompaninë “Politecnica”, pronë e Enea Sermasi e vetë Bujar Demjahat dhe “POLICETNICA-INGEGNERIA ED ARCHITETTURA”. Kjo kompani del të jetë hisenike edhe në fondet e Ministrisë së Infrastrukturës për mirëmbajtjen e rrugëve.
2. **“A&A”**, kompani nga Prishtina, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, në vitin 2011 i ka dhënë tenderin “Sanimi i rrafshit rrëshqitës në lagjen Arbëria”. Për këtë tender Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka gjetur parregullsi. Këtë kontratë e ka marrë bashkë me kompaninë “Soal”, pronarë Remzi Isma, Bardhyl Male dhe kompaninë “Gekos” pronarë e Enver Maliqi, Driton Shuki.

“Kontrata për ”Sanimi i rrafshit rrëshqitës në lagjen Arbëria” në vlerë prej 696,258€ ishte nënshkruar me datën 05.10.2011. Sipas kësaj kontrate, kompania kontraktuese duhej ta bënte stabilizimin e terrenit në rrugën “Ekrem Rexha”. Kjo duhet të bëhet brenda 30 ditëve sipas planit dinamik. Kontrata duhet të paguhet në pjesë. Pjesa e parë do të paguhet 200,000€ pas kryerjes së furnizimeve të parapara me kontratë, dhe konfirmimit nga menaxheri i projektit. Pjesa e dytë dhe tretë duhej të paguhej pasi menaxheri i projektit i komunës konfirmon se punimet janë kryer. Sipas kontratës, pagesa e parë bëhet në bazë të furnizimit, por ne patëm vështirësi t’i krahasonim faturat e furnizimeve të bëra nga kompania. Këto nuk mund të identifikoheshin në paramasën dhe parallogaritë e bëra nga komuna. Deri me datën 14.11.2011, për këtë projekt ishin paguar 500,000€. Pavarësisht këtyre mangësive, projekti megjithatë u përfundua sipas kontratës”, konstaton ZAP në raportin për Komunën e Prishtinës për vitin fiskal 2011, raport i publikuar në qershor të viti 2012.

3. **“AB Dienstleistung GmbH”**, pronë e Albulena e Bekim Brestovcit, në vitin 2010 është shpërblyer nga Komuna e Prishtinës me tenderin: “Mirëmbajtja e objekteve të Qendrave të Mjekësisë Familjare në Prishtinë”, që peshon mbi 16 mijë euro. Këtë kompani e kishte shpërblyer në vitin 2011 edhe Universiteti i Prishtinës (UP) me tenderin: "Mirëmbajtja dhe pastrimin e hapësirave dhe objekteve të Universiteti i Prishtinës ", me nr prokurimit. 90400/10/138/211, por i cili u anulua pasi që i ishte dhënë kundërligjshëm kësaj kompanie. Anulimi i këtij tenderi u bë pas ankesës së kompanisë "MSS" nga Prishtina. Ankesa e kësaj kompanie ishte bërës shkak për anulimin ethe të një tenderi për pastrim të objekteve të “AB Dienstleistung” në vitin 2010, të dhënë kundërligjshëm nga ana e institucionit : QKSPEZH. Edhe në vitin 2011, ishte kompania e njëjtë: “MSS-Mobile Sanitary Service ", ishte ajo që anuloi tenderin: “Pastrimi i Shkollës së Gjelbër dhe të anekseve të shkollave fillore "Naim Frashëri Pyetësori Dardania", me nr prokurimit. 616/11/001/221, që iu dha kundërligjshëm kompanisë “AB Dienstleistung” nga ana e Komunës së Prishtinës. Kjo kompani nuk ishte ndalur së kërkuari tenderët për pastrim. Në vitin 2010 me një tender për pastrimin e objekteve të administratës komunale,tender që peshon 1300 euro, u shpërblye nga Komuna e Drenasit. “AB Dienstleistung GmbH” në vitin 2011 është kontraktuar edhe Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) për pastrimin objekteve të këtij institucioni me një kontratë ku ART-ja do t’i paguaj 380 euro në muaj kësaj kompanie. Person kontaktues në këtë kontratë është shënuar Halil Mustafa. Me një kontratë për pastrim, të vlefshme mbi 7700 euro, këtë kompani e shpërbleu në vitin 2011 përsëri Komuna e Prishtinës. Personi kontaktues në këtë njoftim është mbajtur i fshehur.
4. **“ABC”, kompani nga Podujeva**, pronë e Arben Jetullahut, është kontraktor i rregullte i Komunës së Prishtinës. Preportr, në hulumtimin mbi tenderët me vlera të mëdha dhe të mesme, pa i përfshirë tenderët e tjerë, ka gjetur se kjo kompani vetëm për tri vite, 2010-1012 ka marrë tenderë dhe hise nga tenderë, duke hyrë në konzorciume, vlera e të cilëve mbërrin në mbi 6.2 milionë euro. Kjo kompani ka vazhduar të shpërblehet me tenderë edhe pse në vitin 2009, nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale në Komunën e Prishtinës ishte futur në listën e kompanive që patën shkelur kontratat publike. Kjo kompani, bashkë me Kompaninë “All Zone” kishte qenë në konzorcium kur u shpërblyen me tenderin për rregullimin e Shesiht “Ibrahim Rugova”, por u tërhoq nag konzorciumi. “9 kompanitë për të cilat Drejtoria e Infrastrukturës Lokale konstatoi se

nuk i kanë përmbushur kontratat janë: "Linda" nga Ferizaj, "Toifor" nga Prishtina, "Noti" nga Prishtina, "ABC" nga Podujeva, "Park projekt" e NTP "Dellova" nga Prishtina, "Gashi-ing" nga Suhareka, "Ekskavatori" nga Ferizaj, "Euro-Garden" nga Lipjani dhe "Unikom" nga Suhareka. Pos që nuk u ndëshkua asnjëra nga to, disa prej tyre sivjet edhe janë shpërblyer me tenderë, siç janë: "Toifor" nga Prishtina, "ABC" nga Podujeva, "Park projekt", "Euro-Garden" nga Lipjani etj. Arsyetimi i komunës është se atyre u intereson veç çmimi", raportonin mediet në vitin 2010.

5. **N.N.T. " AEE "**, pronë e Daut Krasniqit dhe Admir Jasharti në vitin 2009 ka marr nga Komuna e Prishtinës tenderin "Furnizimi me gjenerator për shkolla dhe QMF-te të Prishtinës", që peshon mbi 100 mijë euro. Në një procesverbal të Komunës së Rahovecit të vitit 2011, një kompani me emrin "AEE" përshkruhet si përfituese e një tenderi publik të viti 2006 për marrjen ën shfrytëzim të e lokaleve për rezerva shtetërore në Xërxe bashkë me kompaninë "OLT", por që ka pasur probleme në pagimin e qirasë. Megjithë problemet, ajo del që ende shfrytëzon këto lokal, madje, çuditërisht, duke qenë vetë qiraxhi, ajo ua lëshon lokalet kompanive të tjera me qira.
6. **NNT,, ALFA- I "** nga Istogu, pronë e Halil Jahaj, në vitin 2009 në konzorcium me kompaninë "Infratek", pronë e Florie Jahaj, nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderin "Hartimi i projektit Unaza e brendshme-pjesa lindore" që peshon afro 380 mijë euro. Në vitin 2010 ishte shpërblyer nga Komuna e Suharekës me tenderin "Rivitalizimi i ujit Furnizimi në fshatin Peqan", për të cilën kompania "Al-Ber" ishte ankuar në OSHP, por e humbi rastin. Në këtë komunë, kjo kompani kishte qen kontraktor edhe vite më parë, ku në raportin e ZAP për Suharekën në vitin 2007, "Alfa" gjendet si kontraktor i shumë-fisht, njëherit edhe si kompani që komuna i ka borxh. Në vitin 2011 kjo kompani , për tenderin "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Cerravik" të Komunës së Klinës që udhëhiqet nga Sokola Bashota i PDK-së, kishte ofertuar, sipas OSHP-së, me një çmim jashtë normalës të ulët, për çka u konsiderua edhe si kompani e papërgjegjshme, në këtë tenderë, që u anulua. Mediat për këtë tender kishin shkruar me tituj si: 'Bashota lë pa ujë katundin e tij'. Kjo kompani, në raportin e kontratave të publikuar nga KRPP-ja në vitin 2008, del të jetë përfituese e dy kontratave publike me vlerë të ulët. Edhe vitin që lamë pas, për një kontratë publike prej 8 mijë eurosh "Alfa-I" nga Istogu është kontraktuar nga Komuna e Mitrovicës që udhëhiqet nga Avni Kastrati i PDK-së. Po në këtë vit, kjo kompani është kontraktuar për "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË FSHATIN KOSH – KOMUNA E ISTOGUT" nga OJQ-ja "DEVELOPING TOGETHER", kontratë kjo që peshon mbi 100 mijë euro. Për ndërtimin e ujësjellësit Dobrushë – Saradran – Zallq, kjo kompani në vitin 2009 ishte kontraktuar nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL). Ky tender ka qenë mbi 100 mijë euro i vlefshëm. Në vitin 2008, kjo kompani, bashkë me tri kompani tjera, ishte pjesë e projektit që kishte fituar Komuna e Gjilanit, e udhëhequr nga Qemajl Mustafa, nga Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim për ndërtimin e një fabrike të ujit. Kjo kompani, del të jetë kontraktore edhe e komunës së Rahovecit, dhe njëra ndër kompanitë që kishin paraqitur në vitin 2011, te kryetari Smajl Latifaj, ankesë që kanë problem në teren për realizimin e projekteve.
7. **N.T.SH. " AGRO KOP "**, pronë e Minir Hasanit dhe që si person kontaktues në tender del edhe Milaim Bejta, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë dy tenderë që peshojnë bashkë afro 170 mijë euro. Në vitin 2011 me një tender prej afro 10 mijë eurosh është kontraktuar edhe nga komuna e Kllokotit. Në vitin 2012, nga Komuna e Novobërdës, u kontraktua për furnizim me

pleh artificial për te mbjellat vjeshtore, ku kompania do të paguhej 510 euro për çdo ton furnizimi, sipas kërkesave të komunës. Në po këtë vit, kishte përfituar një kontratë nga Kompania regjionale "Ambienti", që peshonte 23 mijë euro. Kompani "Pastrimi", që udhëhiqte tash nga ish-sefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Feim Salihu, në vitin 2012 kontraktori këtë kompani për furnizim me kontejnerë. Kontrata peshon 120 mijë euro.

8. **N.T.P. " AGRO - VET "**, pronë e Stojan Antia nga Fushë Kosova në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për "Përcaktimin e pjellorisë së tokës", tender ky që peshon afro 30 mijë euro. Komuna e Obiliqit ka memorandum bashkëpunimi, të nënshkruar në vitin 2010, me një OJQ, që paraqitet me emrin 'Agro –Vet Development". Bashkëpunimi i tyre është shtrirë në fushën e projekteve për të mirën e ambientit.
9. **" AL - TRADE " SH.P.K.**, pronë e Bajram Gashanit, në vitin 2009 ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderin "Ndërtimi i shkollës së gjelbër në Prishtinë", që peshon 1.4 milionë euro. Kjo kompani është shumë e pranishme në tenderët publik, pronari i se cilës është me origjinë nga qendër-peshimi i PDK-së, Drenasi. Kjo kompani, vetëm në Ministrinë e Arsimit ka marrë shtatë tenderë me vlerë prej afro 9 milionë euro. Kjo kompani në konzorcium me kompaninë "Ada Consulting Group", pronë e zyrtarit të Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK), Avni Kastrati, ka marrë një tender prej 600 mijë eurosh nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithëse, sipas Auditorit Gjeneral ishin shkelur kërkesat e donatorit, Ambasadës Britaneze për procedura të veçanta të prokurimit, Ministria e Kthimit ia ka vazhduar kontratën kësaj kompanie për projektin për ndërtimin e banesave për minoritete.
10. **NP,, ALFAING"** nga Prizreni, pronë e Ridvan Elezi nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011 dhe 2012 ka marr dy tenderë për hartim projektesh, që së bashku peshojnë mbi 34 mijë euro. Nga komuna e Parteshit në vitin 2012 është kontraktuar për ujësjellësin fshatit Partesh, projekt ky që peshon mbi 115 mijë euro.
11. **"ALKO - IMPEX -GENERAL CONSTUCTION -SH.P.K."**, pronë e Imer Ademit, nga Komuna e Prishtinës, në tenderët që ka këqyrë Preportr, del deri më tani të jetë fituese e tenderi "Ndërtimi i rrugës "Qemajl Stafa", që peshon mbi 870 mijë euro. Por, kjo kompani është edhe e kontraktuara për rindërtimin e rrugës 'Bill Klinton", kontratë që e fitoi në vitin 2010, dhe që peshonte mbi 1.6 milionë euro. Në vitin 2008, ZAP kishte gjetur se Komuna e Prishtinës bëri shkelje në tenderin për ndërtimin e rrugës Slivovë - Viti e Marevcit, ku për situacionin e dytë është paguar shuma prej 505,000 eurosh nga MTPT-ja në bazë të faturimit, ndonëse punimet për këtë vlerë të paguar nuk ishin kryer, derisa dosja standarde e tenderit për kompaninë fituese **"Alko Impex"**, nuk është gjetur komplet. Kjo kompani kishte qenë edhe në garën për tenderin "Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës -drejtimi i Veternikut", tender i ndarë në tri pjesë, ku dy pjesë të tij i ka fituar kontraktori tradicional i Prishtinës, Ragip Mustafa me kompaninë "Olti Trasing". "Alko Impex" bëri ankesë në OSHP kundër dhënies së tenderit për kompaninë e biznesmenit Ragip Mustafa, por OSHP-ja ia hodhi poshtë ankesën si të pabazë. Për këtë tender kishte bërë ankesë edhe "R&Rrukolli" nga Skënderaj, financues i PDK-së, si dhe përfitues i tenderëve nga institucionet që drejtohen nga njerëz të PDK-së, por edhe ai e humbi rastin në OSHP kundër Komunës së Prishtinës, derisa komuna u lejua që të nënshkruaj kontratë që pjesën e parë ta kryej "Olti Trasing" me "Beni Com", një punë që prej 2.1 milionë eurosh,

pjesnë e dytë :“Beni Construction&Jaha Company” e që peshon mbi 680 mijë euro dhe pjesën e tretë e fitoi “KASTRIOTI & ARHIKO ING“, kontratë që peshon 2.3 milionë euro. Kjo kompani është kontraktor e rregullt e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), ku merr hise, pos në tenderët e rregullimit të infrastrukturës, po ashtu edhe në tenderët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve. Sipas gjetjeve të Preportr, në MI, që atëherë quhej Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit (MTPT), “Alko Impex” ka marrë tenderë në vlerë afro 6 milionë euro, vetëm deri në vitin 2011.

- 12. "ALL ZONE" SH.P.K.**, pronë e Bekim, Valon, Besnik Zymberi nga komuna e Prishtinës, që nga viti 2009 e deri në vitin 2012 ka marrë tenderë vetë dhe hise në tenderë, duke qenë pjesë e konzorciumeve, që së bashku kapin një vlerë mbi 11.7 milionë euro. Komuna e Prishtinës, vitin që shkoi ia besoj kësaj kompanie, në konzorcium me kompaninë “ABC” nga Podujeve që të ndërtojnë sheshin “Ibrahim Rugova”, derisa në garë ishte edhe kompania me famë ndërkombëtare në fushën e ndërtimitarisë, “Mabetex”, e krijuar nga zëvendëskryeministri i parë kosovar, lideri i Aleancës Aleanca Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli. Për këtë punë, pas nisjes së punëve, “ABC” u tërhoq nga tenderi. Preportr kishte shtruar pyetje në Komunën e Prishtinës, mbi faktin pse u shpërblye kjo kompani që në vitin 2009 u gjet se e mashtrroi Komunën e Prishtinës, duke i shitur kamionë zjarrëfiksish mbi 27 herë më shtrenjtë se sa i kishte deklaruar në doganë. Komuna nuk është përgjigjur, deri sa ZAP në raportin për vitin fiskal 2009 evidentoi këtë si shkelje, derisa “Prishtina Insight” kishte gjetur se krejt kompanitë në garë ishin të ndërlidhura mes vete, duke e bërë kështu vetë tenderin të kurdisur. Preportr në hulumtimin “KEK-Korporata e Korrupsionit” gjeti se kompania “Pro Trade” e Suzana Zymberit, që ishte pjesë edhe e tenderit që doli të jetë i kurdisur, ka marrë tenderë publik në KEK. “Pro Trade”, kompani në pronësi të Suzana Zymberi e që për person kontaktues ka Valon Zymberin, në vitin 2011 në KEK ka marrë tenderin “Furnizim me material izolues për DPQ” që peshon 73,742 euro. Në vitin 2010 “Por Trade” në lagjen më të frekuentuar ka marrë me koncesion edhe nënkalimin në lagjen “Pejton”. Nga ndërtimi me koncesion i nënkalimit dhe dhënia me qira e tij, komuna fiton 160 euro qira mujore. Edhe pse në ndërtim e sipër, zyrtarët komunalë kishin thënë se ai do t’i ketë 7 lokale dhe disa ËC publike, më pas nuk doli kështu. Nënkalimi sot ka 10 lokale, duke përfshirë këtu edhe lokalin "URBANO & FOOD COFFEE" që është pronë e Besnik Zymberit. Ndërkohë që ky lokal ka zaptuar një pjesë të mirë të pronës publike me vendosjen e karrigeve jashtë lokalit, ani pse zyrtarët komunalë thonë se i ka me leje. Besnik Zymberi ka në pronësi edhe biznesin N.P. " Gold Benz - 2 " si dhe " KOSENG GROUP " SH.P.K., ku ka për ortak biznesmenin Gazmend Kelmendi. “Pro Trade” e Suzana Zymberit, nga viti 2008-2011 ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderë në vlerë prej 883 mijë eurosh.
- 13. N.T.P. " ALMAKOS "**, pronë e Milaim Cakiqit ka marrë në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 tenderin “Furnizim me kamion dhe me makina për kositje te barit dhe largimin e borës”. Këtë tender e ka marr bashkë me kompaninë “Profitech”, pronë e **Basri Asllanit**. Kjo kompani ka marrë nga **KEK në vitin 2010**, në kategorinë e tenderëve të mëdhenj, një tender prej afro 490 mijë eurosh. Në po këtë vit, për mos përmbushje të dy kontratave të dala nga tenderë në vlera më të vogla, “Profitech”, është dënuar nga KEK-u me nga 10 % të vlerës së kontratës. **-Cakiqi i “ALMAKOS”** është biznesmen që në kompani të ndryshme është bashkë-aksionar më vëllain e vogël të kryeministrit Thaçi, Blerimin. Cakiqi e Thaçi janë aksionarë bashkë në

kompaninë N.T.P "Almakos", kurse Cakiqi me kushërinj e vëllezër ka edhe kompanitë "Liria F.C-2" Sh.p.k. kompaninë "Ndërmarrja e re Metamb" Sh.p.k ka. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm pati konstatuar se ka pasur manipulime në një proces privatizimi të ndërmarrjes Kosova Elektro ku fitues ishte shpallur më 19 nëntor 2008 kompania Liria FC pronë e Fazli Cakiqit, i afërm i Milaim Cakiqit. "Në kontratën Kosova Elektro, ne kemi vërejtur se gjatë procesit të privatizimit AKP-ja ka manipuluar me sipërfaqen e lokalit të privatizuar. Ne kemi vërejtur parregullsi dhe transparencë të pamjaftueshme në procesin e privatizimit, si rezultat i një konkurrence të padrejtë ndërmjet ofertuesve," pati konstatuar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo kompani pati blerë këtë ndërmarrje për 1 milion e 50 mijë euro. Së fundi është publikuar edhe në vizitën e famshme të kryeministrit Thaçi në restaurantin "Balkanika" në Shkup, ai ishte vozitur me MBË X 5-shin e Milaim Cakiqit. "TV A1" nga Maqedonia kishte raportuar në shkurt të vitit 2009 se kreu i ekzekutivit në Kosovë kishte qëndruar në këtë restaurant dhe video-raporti ishte bërë shpejt i famshëm në internet. Thaçi atëherë i kishte thënë televizionit maqedonas se ishte në qëndrim privat dhe në të njëjtën kohë zëdhënësi i atëhershëm i Qeverisë, Memli Krasniqi, kishte thënë se kreu i ekzekutivit atë pasdite e kishte pasur të lirë. Thaçi nuk e ka sqaruar ndonjëherë më tej këtë vizitë publikisht. Por, vetura me të cilën Thaçi kishte shkuar në Maqedoni nuk ishte as pronë shtetërore e as e tij. Cakiqi kishte qenë aksionar edhe në kompaninë "Boxon", që më vonë ndërron emrin në "Ove Group". E, "OVE Group", që aktualisht për pronarë ka Visar Banjica e Njomza Rrecaj, në KEK në vitin 2011 ka marrë tenderin "Furnizim me rula" që peshon veç 6,886 euro. Por, kjo kompani është kompania që u ankua kundër KEK-ut për tenderin e datës 14.03.2012 për "Shitja e Thëngjillit" që në këtë datë i ishte dhënë konzorciumit "NTN GERGURI – ZYSKENTRANS". Ishte ankesa e "OVE Group" në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) që anuloi këtë tender. Tenderi është rishpallë, por më 2 korrik 2012 është anuluar përsëri, tash nga vetë KEK-u, me arsyetimin se mungojnë kompanitë e përgjegjshme. Kjo kompani është e lidhur me bizneset e familjes së kryeministrit Hashim Thaçi, vetëm nëpërmjet ortakut të Blerim Thaçit, nëpërmjet Milaim Cakiqit, por edhe nëpërmjet babait të Visar Banjicës, Hajatit. Ky i fundit është bartës licence për "Geo Mineral" që operon në Astrazub të Malishevës, derisa për këtë kompani në disa furnizime me naftë në "Kosova Petrol" të Bedri Selmanajt figuron vëllai i Kryeministrit Thaçi, Idriz Thaçi.

14. **N.T.P. "AMICI"**, pronë e Armend Selimit, në vitin 2011 dhe 2012 ka furnizuar me uniforma brigadën e zjarrfikësve, i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës, ku vlera e dy tenderëve mbërrin në 86 mijë euro.
15. **"Andi & Alb Architect"**, kompani nga Prishtina, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për punën "Punimi i projektit për renovimin e bibliotekës "Hyvzi Sylejmani" në Taslixhe, Prishtinë, punë prej 2870 eurosh. Edhe nga Dogana e Kosovës kjo kompani ishte kontraktuar për tenderin "Ndërtimi i mbulojës ne Piken e Kalimit Kufitar Dheu i Bardhë dhe Merdarë", tender që peshon mbi 70 mijë euro. Në këtë njoftim për dhënie tenderi, si person i autorizuar del Faruk Kryeziu. Në vitin 2010 kësaj konzorciumi i ishte dhënë një tender nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), tenderi për rinovimin e stacionit policor në Zveçan, tender që peshon 60 mijë euro, por që iu dha duke u shkelur kriteret e tenderit, pasi që kompania kishte paraqitur në dokumentet e saja qarkullim vetëm për atë vit, derisa kukohej qarkullimi për tri vite me radhë.

- 16. APE&Ivanisin.Kabashi.ArHITEKTI d.o.o**, kompani nga Zagrebi, në vitin 2012 është kontraktuar për hartimi e planit rregullativ "Prishtina e Re"-Zona Perëndim, projekt që kushtoi mbi 151 mijë euro. Person kontaktues për këtë tender është shkruar Mirela Cordas.
- 17. "Apollonia"**, kompani nga Podujeva, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, në vitin 2012 nga kjo komunë është shpërblyer me tenderin 'Ndërtimi i këndeve për lojëra', tender që peshon 67 mijë euro. Në këtë tender, kjo kompani, është në konzorcium me "Global Ing", po ashtu nga Podujeva, dhe njejtë, si kjo, kompani të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues. Kjo kompani në Komunën e Podujevës, që udhëhiqet nga Agim Veliu i LDK-së, është shpërblyer me tenderin "Ndërtimi i rrugës në lagjet "Dushi-Menxhiqi" në Lupç të Epërm(faza I)", që peshon mbi 85 mijë euro; me tenderin "Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë e Poshtme" që peshon afro 130 mijë euro; asfaltimi i fshatit Gërdovc, tender që peshon 50 mijë euro; punimet në rrjetin e kanalizimit fekal, në fshatin Shtedim që peshon 184 mijë euro; Furnizimi me material ndërtimor për kulme për familjet ne gjendje te rendë sociale në vlerë prej 39 mijë eurosh dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në Lagjen e Kastatëve në Kërpimëh në një gjatësi prej 4126 m dhe vlerë rreth 68 mijë euro. Në këtë komunë, prej viti 2007, kishte qenë kjo kompani si kontraktore e rregullt, duke përfshirë këtu edhe furnizimet me naftë, por as në këto kontrata nuk iu publikua emri i ndonjë personi kontaktues të saj. Në Komunën e Lipjanit, të udhëhequr nga Shukri Buja i PDK-së, nëpërmjet një projekti që po e financonte MAPI-ja, në vitin 2009, ishte kontraktuar për Asfaltimi i tri rrugëve të qytetit"Rr. Adem-Hamzë Jashari", Rr. Aleksandër Stipqeviq" dhe Rr. Isa Demaj. Vlera e kësaj kontrate ishte 333 mijë euro. Në këtë komunë, në vitin 2010 kishte përfunduar asfaltimin e rrugës në fshatin Dobrajë e Madh, projekt ky që kishte kushtuar mbi 590 mijë euro, si dhe asfaltimin e rrugës në fshatin 'Blinajë', ish-Vërrshevci, që ka kushtuar 160 mijë euro.
- 18. "Arberi NS"**, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, bashkë me kompaninë "Jehona", pronë e Hazir Krasniqit ka marrë hise në tenderin "Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec-Hajkobillë", që peshon 265 mijë euro. Në hulumtimin "100 milionë", Preportr ka gjetur se për PDK-në ishin dhënë donacion 500 euro nga një biznes me numrin: 80266375. Në regjistrat e Ministrisë së Tregtisë del që është kompania N.N.P. " Arbëri -NS ", pronë e Naim Selmanit. Ky financues i PDK-së mori nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) tenderin "Ndërtimi i objektit të Gjykatave në Malishevë", që peshon 395 mijë euro. Po në këtë vit, në konzorcium me kompaninë "Dijamanti" mori nga komuna e Prizrenit, komunë e PDK-së, një tender prej 27 mijë eurosh për "Ndërtimin e objektit te zyrës civile ne fshatin Velezhë te Prizrenit". Në vitin 2011, nga komuna e Malishevës mori tenderin "NDËRTIMI I SHKOLLËS „HILMI HOTI" NË FSHATIN CARRALLUKË" tender që peshon 457 mijë euro, si dhe nga komuna e Shtimes, po ashtu komunë e PDK-së, mori tenderin "RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT NË SHTIME", që peshon 234 mijë euro. Në vitin 2012, nga Komuna e Mitrovicës kjo kompani është kontraktuar për ndërtimin e Qendrës Kulturore për Komunitete, tender që peshon 87 mijë euro. Nga kjo komunë është shpërblyer në vitin 2012 edhe me një tender tjetër prej mbi 40 mijë eurosh. Në një publikim të Qendrës së VETËVENDOSJES për Malishevën, të titulluar: 'Zyra e Prokurimit në Malishevë financuese e PDK-së", në lidhje me këtë kompani thuhet: "Arbëri-NS" prone e Naim Selmanajt, i cili është vëllai i Shefit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim Selmanajt ka fituar nga

Komuna e Malishevës 7 tenderë në vlerë 1.319.422. I njëjti biznes në vitin 2009 dhe 2010 ka financuar PDK-në në vlerë 4000 euro.”

- 19. N.N.P. "ARHIKO .ING"**, pronë e Skender Cakaj, Shefshet Morina, nga Komuna e Prishtinës, në konzorcium më kompaninë “Kastrioti” nga SHTimja, me pronar Kastriot Fazlija, është shpërblyer me tenderin “Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës -drejtimi i Veternikut,pjesa e tretë”, që peshon 2.3 milionë euro, për të cilin ka pasur ankesa në OSHP nga “Alko Impex”. Për këtë kompani Komuna e Klinës kishte shkëlur ligjin kur i dha tenderin për rregullimin e ujësjellësit në fshatin Cerrovik, që është edhe fshati i kryetarit të Klinës, Sokol Bashota, konstaton OSHP-ja. Në komunën e Kamenicës ishte shpërblyer me një punë prej 85 mijë eurosh për projektin për rregullimin e një pjese të shtratit të përroit të Rubocit. Konzorciumi “Aqua Projekt”shpk&NNP”Arhiko.ING”, në vitin 2011 nga Komuna e Deçanit ishte shpërblyer me tenderin “Mbikëqyrja profesionale e projekteve gjatë realizimit të tyre në teren”, që është lidhur me vlerë për një si, e që është **6.06%** për njësi. Për tenderin “Ndertimi i depose ne njesin punuese ne Komoran” kjo kompani ishte kontraktuar nga ndërmarrja ‘Ibër-Lepenc’, me një kontratë që peshon 31 mijë euro. Në vitin 2009 kjo kompani ishte kontraktuar nga Komuna e Vushtrisë, për projektin e punimit me kubëza betoni i Rr. “ Bajram Curri”, projekt i bashkë-financuar ngaMAPL-ja, kontratë që peshonte mbi 30 mijë euro. Në komunën e Vushtrisë, në listën publike të projekteve të realizuara në vitet 2008-2009, kjo kompani figuron në më shumë se 15 projekte, si furnizuese. Po këtë vit ZAP gjeti se në dy projekte kompania në fjalë shkeli kontratën por Komuna e Vushtrisë nuk zbatoi ligjin, që ta penalizojë. Kjo kompani është kontraktore edhe e Ministrisë Drejtësisë së drejtuar nga Hajredin Kuçi, ku në vitin 2011 me një tender që peshon 46 mijë euro kjo kompani u angazhua për hapjen e puseve për furnizim me ujë në Burgun e Dubravës. Kjo kompani ka guxuar të merret edhe me trashëgiminë kulturore, ku në Ministrinë e Kulturës të udhëhequr nga Memli Krasniqi, në vitin 2011, është shpërblyer me tenderin “KONSERVIMI DHE DRENAZHIMI I SAHAT KULLËS NË PRISHTINË”, që peshon 4900 euro. Instituti GAP ne publikimin e tyre” Letërnjoftimi i Kamenicës” të publikuar në vitin 2012 konstaton se në 2010 dhe 2011 Komuna ka angazhuar kompaninë NNP “Arhiko-Ing” nga Prishtina për të mbikëqyrur projektet investive, tender që peshon 58 mijë euro. Sipas gjetjeve të këtij instituti, edhe auditori i brendshëm ka konstatuar se mbikëqyrja e projekteve nuk është duke u bërë në përputhje me normat ligjore nga kjo kompani.
- 20. NTP,,ARTINI ”**, Pronë e Zijavere dhe Jahiri Ahmeti është shpërblyer në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës me tenderin “Furnizimi me libra për Bibliotekën e qytetit dhe Bibliotekat e shkollave” që peshon 33 mijë euro. Për pajisje me vepra letrare në bibliotekat Shkollore kjo kompani u kontraktua në vitin 2011 edhe nga komuna e Obiliqit, punë që u pagua pak më shumë se 2 mijë euro.
- 21. “AUTO KAÇANDOLLI ” SH.P.K.**, pronë e Skënder Kaçandollit, në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e Prishtinës për “Furnizim me automjete për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe sociale”, tender që peshon 85 mijë euro. Vitin që shkoi kjo kompani u kontraktua nga Qeveria e Kosovës për t’ia blerë një makinë prej 14 mijë eurosh Akademisë së Shkencave dhe të Arteve (ASHAK). Skënder Kaçandolli ka pasur në pronësi edhe kompaninë “Auto Color”, me të cilën ishte kontraktuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për blerje veturash e që sipas raporteve të auditimit të brendshëm të BQK-së, makinat dolën me defekt. Kaçandolli e shuajti këtë



kompani pasiqë ishte edhe borxhli i ATK-së, por në vitin 2009 ishte shpërblyer përsëri nga BQK-ja, me tenderin për furnizim me vetura prej 77 mijë eurosh.

- 22. N.P.SH. "BAGERI"**, pronë e Bujar Shabanit nga Ferizaj, në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 është shpërblyer me tenderin "Asfaltimi i rrugëve ne Shkabaj dhe Rimanishte", që peshon 124 mijë euro. Kompania "Bageri", në vitin 2009 kishte dhënë 1 mijë euro donacion për PDK-në, është kontraktor i disa institucioneve që udhëheq kjo parti. Në vitin që dha donacionin për PDK-në, nga Ish-MTPT-ja "Bageri" u shpërblye me një tender prej 829 569 eurosh, për të marrë një vit më vonë nga komuna e Lipjanit, që udhëhiqet nga Shukri Buja nga PDK-ja 124 mijë euro për asfaltimin e rrugës "Haxhi Kleqka". Kjo kompani në vitin 2011, së bashku me kompaninë "Xhyli Commerce" ishte kontraktuar nga komuna e Mitrovicës, që udhëhiqet nga Avni Kastrati nga radhët e PDK-së për të asfaltuar një rrugë prej 2 kilometrash në fshatin Zhabar, ndërtimi i së cilës komunës i kushtoi 110 mijë euro. Në po këtë vit, "Bageri" fiton nga komuna e Obiliqit tenderin prej 173 mijë eurosh për rregullimin e rrugës Mazgit – Magjistrale, dhe nga kjo komunë ishte pranuar edhe si nënkontraktor i kompanisë "Gërguri" në një punë të kësaj kompanie që peshonte 53 mijë euro. Në komunën e Ferizajt, që udhëhiqje deri tash nga Bajrush Xhemajli, po ashtu nga radhët e PDK-së, administrata komunale kishte shkelur ligjin mbi financat publike për "Bagerin". Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në vitin 2009, për asfaltimin e rrugës në fshatin Komogllavë, projekt që i kushtoi komunës mbi 125 mijë euro, komuna e Ferizajt kishte paguar këste në vlerë më të madhe se sa që parashihte kontrata me "Bagerin", në favor të kompanisë dhe këtë gjetje e kishte futur tek shkeljet që i klasifikoi si "rrezik i lartë". Kjo kompani, sipas profilit të saj në internet, si pjesë të saj ka edhe bazën e prodhimit të asfaltit në komunën e Lipjanit, emri i së cilës është "Kosova Asfalt". Kjo e fundit, në një publikim të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor është futur në listën e kompanive të cilat me veprimtarinë e tyre e dëmtojnë ambientin. Në këtë publikim, "Kosova Asfalt" e kompanisë "Bageri" thuhet se ndotë ujërat nëntokësor.
- 23. "N.T.P. " BASS COM "** nga Gjilani, në pronësi të Bujar Alidema dhe Mirzade Dërmaku, në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin "Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec-Hajkobillë", që peshon 236 mijë euro. Në po këtë vit, nga Komuna e Novobërdës është shpërblyer me tenderin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Llabjan rruga Shkoll-Haziraj " që peshon 23 mijë euro si dhe tenderin "Asfaltimi i rrugës ne fshatin Baqevisht", mbi 120 mijë euro. Për asfaltimin e rrugëve në drejtim të ndërtesës së re administrative të komunës së Ranillugu, kjo kompani nga kjo komunë u kontraktua për një tender që peshon 140 mijë euro. Në vitin 2012 kësaj kompanie edhe Komuna e Kamenicës ia dha një tender prej 154 mijë eurosh. Në vitin 2010, Komuna e Gjilanit i dha kësaj kompanie një tender prej 67 mijë eurosh për asfaltimin e rrugës për Partesh.
- 24. "N.N.P. " BEDI NDERTON"**, pronë e Mon Islamaj nga Podujeva, nga viti 2009-2011 në Komunën e Prishtinës ka marrë tender, dhe hise nga tender duke qenë pjesë e konzorciumeve, të cilët kapin shifrën mbi 3.1 milionë euro. Konzorciumi N.N.P. "Kujtimi"&N.N.P. "Bedi Nderton" në vitin 2011 ka marrë nga Ministria e Financave një tender prej 17 mijë eurosh. Në vitin 2012, kjo kompani nga Komuna e Fushë Kosovës është kontraktuar për projektin "Rregullimi i infrastrukturës së jashtme në oborret e objekteve të çerdheve për fëmijë në fshatrat Bardh i

Madh dhe Miradi e Ulët”, vlera e të cilit është 9300 euro dhe person kontaktues është Besime Latifi.

- 25. COMPANY " BEJTA COMMERCE " SH.A.,** pronë e Basri dhe Adem Kçiku nga Gjilani, në vitin 2012 janë shpërblyer nga Komuna e Prishtinës që udhëhiqet nga kryetari I LDK-së, Isa Mustafa me tre tender që peshojnë bashkë mbi 880 mijë euro. “Bejta Comerc”, në dy fushatat zgjedhore, atë të viti 2009 dhe vitit 2010 dha për PDK-në 1499 euro, vetëm në MTPT ka fituar kontrata në vlerë prej 7.5 milionë eurosh. Pas shndërrimit të MTPT-së në MI, “Bejta Comerc” nuk mori asnjë pjesë as në tenderin e “famshëm” të mirëmbajtjes së rrugëve. Ajo, së bashku me një sërë kompanish financuese të PDK-së, dhe jo të tilla, kishte bërë ankesë në OSHP, gjë që qoi deri në prishjen e tenderit, por as pas ri-tenderimit ajo nuk mori asgjë nga puna e mirëmbajtjes së rrugëve regjionale, tender që buxhetit të MI-së i kushtoi mbi 9 milionë euro. Por kjo kompani këtë vit kishte marrë tenderin për asfaltimin e disa fshatrave në komunën e Kamenicës, ani pse OSHP-ja kishte konstatuar se Kamenica shkeli ligjin kur ia dha këtë tender. Kjo kompani për këtë punë, për asfaltimin e mbi 2 kilometrave asfalt e që komunës i kushtoi mbi 175 mijë euro, kishte paraqitur një plan dinamik, sipas të cilit puna do të kryhej vetëm për 6 ditë. Kompania tjetër në garë në këtë tender, “Company Zuka Comerc” kishte pretenduar që komuna e Kamenicës edhe kishte bërë ndryshime të dokumenteve nëpër dosje, që ta nxirrte fitues “Bejta Comercin”. Për shkak të këtyre shkeljeve OSHP-ja e qoi këtë tender në ri-vlerësim. Por për këtë kompani shkeljet e ligjit vazhduan. Në korrik të vitit 2011, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), që udhëhiqet nga ministri i PDK-së, Besim Beqaj, kishte ngritur dyshimin se kryetari i bordit të ndërmarrjes regjionale të Ujësjetës “Hidromorava” në Gjilan, Abdyl Hasani, ka konflikt të interesit. Ky konflikt ishte pikërisht për shkak të faktit se Hasani punonte edhe te “Bejta Comerc” menaxher për kualitete. Vetë Abdyl Hasani, që është i angazhuar nga komuna Gjilanit edhe në Këshillin e Ekspertëve të kësaj komune, në një letër që ia kthen MZHE-së konstaton për vete se nuk ka konflikt të interesit, ani pse “Hidromorava” ka të kontraktuar për furnizim me fraksione të zhallit kompaninë “Bejta Commerce”. “Bejta Comerc” është kompani që është mbështetur edhe nga programi i USAID-it në Kosovë me një kredi prej 900 mijë eurosh.
- 26. " BENI - COM " SH.P.K.,** pronë e Ismet Konushevcit, që nga viti 2010-2012 në Komunën e Prishtinës të udhëhequr tradicionalisht nga LDK-ja ka marrë tender, dhe hise nëpër tender si pjesë e konzorciumeve të cilët kapin vlerën mbi 3 milionë euro. “Beni Com” nga Podujeva në dy fushatat e fundit zgjedhore dha për PDK-në 3900 euro ka marrë nga MTPT-ja, me gjashtë kontrata të ndryshme 9.4 milionë euro. Në vitin që lamë pas, kjo kompani ishte shpallur jashtë-ligjshëm fituese e tenderit mbi 3 milionësh të Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e rrugës Kuqishtë – Bogë, por që u anulua nga OSHP-ja. Për shkeljet që ishin bërë në këtë tender kishte publikuar hulumtime “Preportr”. Në hulumtimin me titull “Biznesi i partisë në pushtet”, me të cilën “Preportr” u shpërblye me çmimin storia më e mirë në media online për vitin 2011, bëhet me dije se kjo kompani ishte shpallur jashtë-ligjshëm fituese e këtij tenderi. Për shkeljet e ligjit që u bënë për financuesin e PDK-së në këtë tender nga MI-ja, që udhëhiqte nga Fehmi Mujota i PDK-së, u raportuan edhe nga mediet tjera. Kjo kompani në konzorcium me “ALFA COM” morri më 2010-ën një tender nga komuna e Drenasit, komunë e PDK-së, në vlerë prej afro 29 mijë eurosh për asfaltimin e një rrugë lokale dhe nga komuna e Vushtrrisë mori edhe 9 mijë

euro tjera në një tender të kuotimit të çmimit. Në vitin 2011, për projekte të ndryshme në Vushtrri "Beni Com" mori edhe 1.2 milionë euro prokurime publike, ani pse disa nga kontratat, punët e të cilave i realizoi në vitin 2011, ishin fituar viteve të mëhershme. "Beni Com" kishte marrë tenderë publik edhe nga komunat që nuk i udhëhiqte PDK-ja, por partia që ishte më të deri në vitin 2010 në koalicion me të, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), tash në opozitë. Në vitin 2010 kjo kompani në konzorcium me kompaninë "CAT Company" kishte kryer punët në asfaltimin e rrugës të Lagjja e Bunjakëve e fshatit Ballofc, projekt me vlerë rreth 127 mijë euro, financuar nga komuna e Podujevës, që udhëhiqet nga Agim Veliu i LDK-së. Nga kjo komunë në vitin 2007 "Beni Com", për ndërtimin e shkollës në "Lagjja e Kuvajtit" pati marrë edhe mbi 37 mijë euro. Viti 2012 nuk iu ka nisur mbarë "Beni Com-it". Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e kishte shpërblyer këtë kompani, në konzorcium me kompaninë "Ndërtimtari" në tenderin për shërbimet e largimit të djerrinës, vlera e se cilit ishte 165 mijë euro. KEK, sipas OSHP-së, kishte bërë disa shkelje të LPP-së dhe tenderi shkoi në ri-vlerësim.

- 27. N.N. " BENI CONSTRUCTION "**, pronë e Arben Shahinit, nga Komuna e Prishtinës që nga viti 2010-2012 ka marrë tender dhe hise në tender, si pjesë e konzorciumeve, një ndër to edhe me "Steda Kosova", pronë e **Rexhep Mavriqi dhe Dashmir Selmani**, që kapin vlerën mbi 2.7 milionë euro. Kjo kompani ishte kontraktore edhe e Policisë së Kosovës për një kontratë të vlefshme prej çmimi 85 mijë euro për disa punë në stacionet e Mushtishtit e të Ranillukut. Për projektin "Punimi dhe montimi i shkalleve emergjente për Shkollën Fillore "Ilaz Thaçi" -Hani i Elezit", Komuna e Hanit ët Elezit angazhoi këtë kompani me një kontratë që peshon 15 mijë euro. Në vitin që lamë pas, 2012, kjo kompani nga Komuna prej nga vjen, Komuna e Vitisë mori një tender prej 170 mijë eurosh. Kjo kompani nga MASHT-i në vitin 2008 pati marrë një tender prej 23 mijë eurosh.
- 28. "BENI DONA PLAST" SH.P.K.**, pronë e Ragip Mustafës, që ka në pronësi edhe biznesin "**Olti Trasing**", është kontraktor i rregullt i Komunës së Prishtinës që udhëhiqet nga lideri i LDK-së. Preportr ka këqyrur një pjesë të tenderëve me vlerë të madhe dhe një pjesë të tenderëve me vlerë të mesme, ku ka gjetur se biznesmeni Mustafa me këto dy kompani ka marrë tenderë dhe hise nga tenderë, si pjesë e konzorciumeve, që kapin vlerën mbi 3.4 milionë euro. Kjo kompani, sipas gjetjeve të ZAP ka qenë një kohë të gjatë e papërgjegjshme ndaj Komunës së Prishtinës, por megjithatë del që ajo është favorizuar duke iu vazhduar kontrata kundërligjshëm, duke ndërtuar ndërtesa kolektive ilegalisht dhe duke vazhduar që të marrë edhe tenderë publik, duke filluar nga furnizimi me xhama, ushqimet për fëmijë të shkollave e deri te ndërtimet. Preportr ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës një koment mbi këto fakte dhe faktin që biznesmeni Ragip Mustafa vazhdon të marr tenderë, por ata nuk janë përgjigjur. Kështu, Preportr ka gjetur se Ragip Mustafa, në lagjën Ulpiana, rruga "Imzot Nikë Prela", ka të ndërtuar ndërtesë kolektive pa leje. Ajo ndërtesë është shumë dukshme, dhe mbi të mbanë plakatën "Beni Dona". Ky biznesmen, "rrugëtimin e favorizmit" nga Komuna e Prishtinës e kishte nisur që në vitin 2005, kur ishte kryetar Ismet Beqiri, tash Sekretar i LDK-së. ZAP në vitin 2006 gjeti se për parkingjet publike nëpër trotuare Komuna e Prishtinës kishte kontraktuar kompaninë "Beni Dona Plast", dhe kompaninë "LTG". ZAP gjeti se të dy kompanitë i mbetën borxh komunës, dhe vlera e borxhit mbërrinte në 164,480. Në vitin 2007 vazhdon "tregimi" për "Beni Dona Plast" të Ragip Mustafës. "Nga viti 2005 Komuna ka pasur kontratë me ndërmarrjen "Beni Dona" për dhënien ne shfrytëzim te

vendeve për parkim publik ne rrugët e qytetit Lot. III dhe IV. Kjo kontratë është vazhduar edhe një herë deri me 30.06.2006. Nga zyrtaret përgjegjës ne Drejtorinë e Shërbimeve Publike është thënë se është vazhduar edhe për vitin 2007. Mirëpo, kjo nuk është ofruar si dëshmi ekipit të auditimit. Sipas kontratës vlera e shumës si kompensim është 7,020 euro për muaj, dhe me kushtet e pagesës brenda 15 ditëve ne fillim te muajit vijues. Gjatë vitit 2007 kjo shumë e pagesës është rishikuar dhe është zvogëluar me arsyetime te ndryshme, pa mbështetje ligjore sipas opinionit tonë. Sipas një raporti përkatës thuhet që obligimet e mbetura për vitin 2007 janë ne vlere 88,817 euro. Po ashtu komuna nuk ka bërë shpalosje në PF të vitit 2007 për të arkëtueshmet e pa inkasuara në vlerë 88,817 euro”, konstaton ZAP në vitin 2007. Gjithashtu kompania “Beni Dona Plast” nga 01.07.2007 deri më 29.02.2008 ka menaxhuar me parkingjet publike pa vazhdim të kontratës dhe borxhi i saj ndaj komunës vlerësohet në €50,137;”, konstaton ZAP kur bëhet fjalë për borxhet në raportin për vitin 2008. Mediet në vitin 2012 kishin raportuar që tenderi prej 2.1 milionë eurosh për “Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës -drejtimi i Veternikut, pjesa e pare” ishte dhënë kundërligjshëm, pasi që kompania ‘Olti trasing’ nuk i kishte kryer disa punë të kontraktuara më herët me Komunën e Prishtinës, dhe që ishte kriter i tenderit. Me këtë pretendim u nisën edhe kompania “Alko Impex” dhe “R&Rukoilli” që të ankoheshin në OSHP, por e humbën rastin.

29. **N.T.P. " BINA - COMM PR "**, pronë e Ahmet Mekolli, në Komunën e Prishtinës në vitin 2008 është shpërblyer me tenderin “Furnizimi me pemë dhe perime për kuzhinën qendrore të Institucioneve Parashkollore në Prishtinë;”, që peshon mbi 160 mijë euro.
30. **“Bini” nga Podujeva**, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, ka marrë tenderë dhe hise nëpër tenderë, si pjesë e konzorciumeve, që kapin shifrën 1.7 milionë euro. Ky biznes është kontraktor edhe I Komunës së Podujevës për një sërë punësh, por edhe atje është mbajtur i fshehur emir i ndonjë personi kontaktues me këtë kompani.
31. **“Blendi”, kompani nga Prishtina**, të cilës kompani, Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, ka marrë në vitin 2011 një llot të tenderit “Furnizimi me material didaktik për shkolla”, ndërsa pjesën tjetër të tij e ka marrë kompania “KGT”, pronë e Tomë Gashit, ndërsa krejt tenderi peshon 51 mijë euro. Në vitin 2012, Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës ka kontraktuar një kompani me emrin : **N.T.G. “ BLENDI ”**, që për person kontaktues ka **Shaip Ramën** për tenderin “ Furnizim me tonerë ( ngjyra) për printerë në AUV” që peshon mbi 9 mijë euro. Kjo kompani ka qenë kontraktore edhe e Komunës së Suharekës dhe Universitetit të Prishtinës. Doganave të Kosovës, Ministrisë së Ambientit dhe institucioneve të tjera.
32. **“Bleta”,** që person kontaktues i së cilës ka del të jetë Milaim Bejta , në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin “Furnizimi me bletë dhe pajisje bletare” që peshon 47 mijë euro.
33. **“Bosch” nga Fushë Kosova**, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, derisa në ARBK figurojnë mbi 15 kompani me këtë emër, nga kjo komunë në vitin 2012 ka marr tenderin “Mirëmbajtja e automjeteve te Komunës “, i vlefshëm mbi 11 mijë euro.
34. **" BOTEK " SH.P.K.**, pronë e Bahri Asllani, Hilmi Asllani , Krenar Sela , Sinan Asllani dh eKushtrim Sela, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011-2012 ka marrë tenderë dhe hise nga tenderë, si pjesë e konzorciumeve, që peshojnë bashkë mbi 490 mijë euro. Kjo kompani është kontraktore

edhe e një sërë institucionesh të nivelit qendror, por edhe e ndërmarrjeve publike, ku kryesisht furnizon me pajisje të kompanisë ndërkombëtare "Dell".

**34. N.N.T. " BREZI KUFITAR "**, pronë e Shemsi Halitit nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë dy tenderë në vlerë mbi 90 mijë euro. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kjo kompani ka marrë një tender prej 32 mijë eurosh, nga ATK-ja është kontraktuar për 'Rregullimin e zyrave ne Regjionin Prishtine2 qe parashihet te vendosen ne objektin e Mekanizimit sipas kërkesave dhe nevojave te ATK-se", punë prej mbi 3 mijë eurosh. Edhe nga Policia e Kosovës ka marrë një punë prej 10 mijë eurosh në vitin 2012.

**35. N.T.P. BUSHGEGU**, pronë e Milaim Bejtës nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tenderë dhe hise nëpër tenderë, si pjesë e konkurrencës në tenderë të ndarë në lloje, të cilët peshojnë mbi 70 mijë euro.

Kjo kompani nga Komuna e Gjakovës që udhëhiqte nga Pal Lekaj i AAK-së, në vitin 2012 ka marr tenderin për furnizim me dru që peshon mbi 100 mijë euro, dhe po këtë vit ka marr nga Agjencioni Pyjor i Kosovës që funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural një kontratë për shitjen e druve, me një çmim prej mbi 4 mijë eurosh, një kontratë për furnizim me dru e thëngjill nga Komuna e Fushë-Kosovës, bashkë me kompaninë NTP " AJRONI COM", kontratë që së bashku peshon mbi 50 mijë euro. Kjo kompani ka furnizuar me masë drunore edhe një sërë institucionesh.

Në vitin 2005, Komuna e Lipjanit kishte deklaruar për këtë kompani para ZAP-it se e njëjta, bashkë edhe me kompaninë NTP "Pajtimi", kishin falsifikuar dokumente për të konkurruar ne tenderin për furnizim me dru.

**36. " ÇLIRIMI " SH.P.K.**, pronë e Salih Dakaj nga Prizreni, nga tenderët e vlerës së madhe dhe të mesme që ka këqyrë Preportr, del që nga Komuna e Prishtinës, nga viti 2009-2012 ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 8.6 milionë euro.

Për tenderët që lidheshin me këtë kompani në vitin 2011 ishin arrestuar një sërë zyrtarësh të Komunës së Prishtinës, duke përfshirë këtu edhe shefin e prokurimit, Ekrem Rexha.

Para se hetuesia të merrej me Ekrem Rexhen, ishte ZAP që gjeti shkeljen të Kolektori Atmosferik, që i ishte dhënë kompanisë "Çlirimi" nga Prizreni, pronë e Sali Dakaj. "Ne projektin "Ndërtimi i kolektorit atmosferik" në shumë prej 3,045,674€ është paguar operatori në vlerë prej 846,712€ për furnizime me material ndërtimi, e jo për punët që ndërlidhen me projektin në fjalë. Me datën 14.12.2010 kësaj kontrate i është shtuar një amendament për ndryshimin e kushteve të pagesës në të cilin është paraparë që operatorit t'i paguhet shuma në emër të furnizimeve me material ndërtimor e jo për punët e kontraktuara", konstatuan më 2010-ën auditorët.

Kjo kompani, nga MASHT-i dhe MTPT-ja në vitin 2008 ka marrë tenderë në vlerë afro 3 milionë euro.

**37. " CODEX " L.L.C.**, pronë e Naim Bajraktarit, në vitin 2011 bashkë me "Steda Kosova", pronë e Rexhep Mavriqit morën tenderin e Komunës së Prishtinës: "Ndërtimi i sheshit "Zahir Pajaziti", kontratë e vlefshme kjo prej 4.5 milionë eurosh.

Kjo kompani në vitin 2009 nga MASHT ka marrë një tender prej mbi 750 mijë eurosh.

**38. NNP,,DAJA RRAH"**, kompani nga Prizreni në pronësi të Rrahim Hoxhës, nga Komuna e Prishtinës në vitet 2011-2012 ka marrë tender në vlerë mbi 640 mijë euro.

Në vitin 2012 nga PTK-ja, bashkë me një sërë kompanish, mori një llot prej 190 mijë eurosh për renovime të objekteve të filialeve të PTK-së nëpër regjione.

87 mijë euro është vlera e kontratës që e ka fituar kjo kompani nga Komuna e Prizrenit për Ndërtimin e Qendrës Kulture Sportive në fshatin Reqan, derisa nga kjo komunë ka marrë edhe një sërë kontratash tjera. Edhe MASHT-i e pati shpërblyer me një kontratë prej 160 mijë eurosh në vitin 2008 "Dajën Rrah".

**39. "Dardania"**, kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderë publikë në vitin 2012, të cilët së bashku peshojnë afro 230 mijë euro.

**40. "Devolli"**, kompani nga Rahoveci, të cilës kompani, Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë, në konzorciumin me kompaninë "Themeli" nga Prizreni, pronë e Qemajl Morinës, ka fituar tenderin "Asfaltimi i rrugës për ndërtimin e kolektorit dhe kanalizimit fekal prej rrugës "Abedin Rexha" deri te lidhja me rrugën "Ibrahim Fehmiu" që peshon afro 200 mijë euro.

Në ARBK janë 6 kompani që mund të jenë kompania "Devolli" që ka kontraktuar Komuna e Prishtinës për këtë projekt, derisa vetë ky institucion nuk ka pranuar të tregojë saktë kush është kjo kompani.

**41. N.SH.T. " DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. "**, pronë e Lulzim Katanolli, që nga viti 2009 fiton tenderin "Dezinsektimi hapësor i Prishtinës". Deri tash ai ka lidhur me Komunën e Prishtinës kontrata publike që peshojnë mbi 400 mijë euro.

**42. NDËRMARRJA PRODHUESE TREGTARE " DUGLAS"**, pronë e Sinan Sfishta, e që në disa tenderë del si person kontaktues edhe Nazim Pireva, nga Komuna e Prishtinës prej vitit 2012 ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 215 mijë eurosh. Pireva është person kontaktues edhe te tenderi prej 19 mijë eurosh "Blerja dhe montimi i trafostacionit 160 kV në Gërmir", që i është dhënë kompanisë "Ndriçimi".

**43. "Edi Med"**, kompania nga Prishtina të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e shërbimit stomatologjik në kuadër të QKMF-së", që peshon mbi 36 mijë euro.

**44. "Edona"**, kompani nga Ferizaj të cilës kompani, Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Hartimi i projektit Unaza e brendshme-pjesa përëndimore", që peshon mbi 200 mijë euro.

**45. N.T.SH.,,EJONA"**, pronë e Hysni Prelvukaj nga Peja, në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tenderë në vlerë prej 29 mijë eurosh.

Kjo kompani ka marrë hise edhe në një tenderë të Ndërmarrjes Publike Banesore që është ndërmarrje publike e Komunës së Prishtinës, tenderi peshon 216 mijë euro. Kjo kompani ka përfituar tenderë publikë edhe nga institucione të tjera.

**46. " EKOINVEST " SH.P.K.,** pronë e Bahri Asllanit, në tenderët e Komunës së Prishtinës ka marrë hise në dy tenderë, si pjesë e konzorciumeve, vlera e të cilëve mbërrin në 460 mijë euro.

Në vitin 2011 kjo kompani ka marrë një llot të një tenderi të "Trepçës" prej 66 mijë eurosh, në vitin 2011 ishte në mesin e 5 kompanive janë propozuar nga KEK-u për Kontrate publike kornizë – me më shumë se një operator ekonomik, për "Furnizim me përcues Al-Fe".

**47. "Ekologjia",** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës", që peshon afro 40 mijë euro.

**48. "Ekonerg",** kompani nga Zagrebi, , të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Hartimi i Planit Zhvillimor Urban", projekt afro 150 mijë eurosh.

**49. "El Shpetimi",** pronë e Sadri Musës nga Podujeva në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin "Furnizimi i shkollave me material higjienik, uji dhe vegla pune", që peshon 46 mijë euro.

**50. "El Trafo Mont",** pronë e Sabri Grajçevci dhe Irfan Kutllovci, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tenderë dhe hise nga tenderë, si pjesë e konzorciumeve, që peshojnë mbi 100 mijë euro.

**51. "Elektra",** pronë e Hebib Dernjani, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 është shpërblyer me tenderin "Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën mbi lumin "Prishtina" në Kalabri", që peshon 146 mijë euro. Kjo kompani, duke pasur në KEK person kontaktues Valon Gashin, në vitin 2011 është kontraktuar për "Furnizim me material për instalimin e njehsorëve gjysmë indirekt me mundësi leximi nga distanca", tender ky që peshon afro 190 mijë euro.

**52. "Elektro Montues",** pronë e Shukri Vitijës, bashkë me kompaninë "Elena" ka marrë një pjesë të tenderit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e Prishtinës", prej 52 mijë eurosh., pjesën tjetër të të cilit, prej 69 mijë eurosh, e ka marrë "Termomontimi", pronë e Skender Mecinajt.

**53. "Elen",** kompani që paraqitet herë nga Vushtrria e herë nga Prishtina, , të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Furnizimi me serra ", që peshon 38 mijë euro, si dhe ka marrë hise nga tenderi "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e Prishtinës", prej 52 mijë eurosh, duke qenë në konzorcium me "Elektro Montues".

**54. "Elting",** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tenderin "Furnizimi dhe montimi i rrjetit kompjuterik (LAN) dhe rrjetit telefonik në katin e parë të Komunës së Re –Drejtoria e Kadastrit", që peshon mbi 10 mijë euro.

**55. "Eltrisi"**, kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2012 dy tenderë të cilët së bashku peshojnë afro 190 mijë euro.

**56. "Eskavatori"**, pronë e Isa, Bajram, Ibush e Haziz Rysha nga Ferizaj, nga Komuna e Prishtinës që drejtohet nga lideri i LDK-së, nga viti 2009-2012 ka marrë tender në vlerë prej 3.2 milionë eurosh.

Kjo kompani në vitin 2008, kur MASHT-in dhe MTPT-në po i udhëheqnin Enver Hoxhaj, respektivisht, Fatmir Limaj, të dy nënkryetarë të PDK-së, ka marrë tenderë, dhe hise nëpër tenderë, duke qenë pjesë e konzorciumeve, të cilët kapin vlerën mbi 11.7 milionë euro.

Ekskavatori nga Drejtorati i infrastrukturës Lokale ishte futur në mesin e 9 kompanive që i kishin shkëlur kontratat me komunën në vitin 2009, por ka vazhduar të shpërblehet nga Komuna e Prishtinës.

**57. "Eup Engeniering"**, pronar e se cilës ende në ARBK, figuron Agjencia Kosovare e Mirëbesimi (AKM), dhe të cilës Komuna e Prishtinës në njoftime për dhënie të tenderëve nuk ia ka publikuar emrin e personit kontaktues, nga kjo komunë ka marrë tender dhe hise nëpër tender, duke qenë pjesë e konzorciumeve, të cilët kapin vlerën prej 61 mijë eurosh.

**58. "Euro Delta"**, pronë e Enver Nezirrit nga Fushë- Kosova në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar për 'Furnizimi e montimi me goma dhe bateri (akumulatorë) për automjetet e Komunës', tender ky që peshon mbi 15 mijë euro. Kjo kompani është edhe kontraktore e PTK-së dhe e "Infrakos-it".

**59. N.P. " EURO ENGINEERING "**, pronë e Ilaz Spahiu, në vitin 2011 ka marrë hise nga tenderi "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugët "Tomori","Tutini","27 Nëntori" dhe lagjen Kaqot dhe kanalizimit në Suteskë dhe rrugën "27 Nëntori"; prej 136 mijë eurosh i Komunës së Prishtinës, duke qenë pjesë një konzorciumi që realizoi këtë projekt.

**60. "Euro Garten"**, pronë e Mentor Salihut nga Lipjani, nga Drejtorati i infrastrukturës Lokale ishte futur në mesin e 9 kompanive që i kishin shkëlur kontratat me komunë në vitin 2009, por ka vazhduar të shpërblehet nga Komuna e Prishtinës. Kështu, nga kjo komunë kjo kompani nga viti 2009-2012 ka marrë tender në vlerë 930 mijë euro.

Në vitin 2010 kishte marrë 3 tenderë nga Komuna e Ferizajt, që atë kohë udhëhiqje nga Bajrush Xhemajli, i dënuar tash nga Gjykata.

Në vitin 2011 nga Komuna e Obilqit ka marrë dy tenderë, që bashkë peshojnë mbi 230 mijë euro.

**61. "Euroashensori"**, pronë e Asllan Ferizit dhe **"Set Ashensori"**, pronë e Rifat Ymeri, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 janë shpërblyer nga Komuna e Prishtinës me tenderin prej 280 mijë eurosh për "Riparimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve në ndërtesat e qytetit për vitin 2012".

**62. "Europa Partners"**, pronë e Mirsad Jetullahu dhe **"Vizion Project"**, pronë e Shpend Musës, kanë marrë bashkë nga Komuna e Prishtinës tenderin "Ndërtimi i shtegut të vrapimit në Taukbahqe-Prishtinë" që peshon 105 mijë euro.



“Europa Partners” në vitin 2012 ka marrë dy tender nga Komuna e Graçanicës, derisa Shpend Musa që për PDK-në dha 2 mijë euro, ka në pronësi kompaninë N.P.N. " Vision Project ". Kjo kompani, sipas gjetjeve të “Preportr”, ishte zgjedhur fituese në një tender prej 25 mijë eurosh nga komuna e Pejës, që udhëhiqet Ali Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), por që tenderi është anuluar pasi që OSHP-ja gjeti shkelje. Ky biznesmen ka në pronësi edhe kompaninë N.T.SH. " Cipa Protech ", më të cilën në vitin 2008 i shiti kompjuterë në vlerë prej 31 mijë eurosh komunës së Gjilanit, komunë e PDK-së. Nga kjo komunë në vitin 2011 ka marrë edhe një tender prej 13 mijë eurosh, kurse në këtë vit, po nga kjo komunë, fitoi tenderin “Furnizim me tonerë për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë”, në vlerë prej 9 mijë eurosh.

**63. “Fauna”,** kompani nga Gjilani që për person kontaktues është gjetur ta ketë Aijah Idrizirin, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tenderin ‘Përkrahja e fermerëve në shpeztari’ projekt 24 mijë eurosh.

**64. “Galanterija Group”,** pronë e Shefqet Imeri dhe Muhamet Ymeri, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2009 ka nënshkruar një kontratë prej 279 mijë eurosh për ‘Furnizimi me inventar shkollor’. Kjo kompani ka pasur në vitin 2009 edhe një kontratë me furnizime të ngjashme me Komunën e Vushtrrisë.

**65. “Gashi Ing”,** pronë e Enver Gashit nga Suhareka në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tre tenderë që së bashku peshojnë afro 480 mijë euro. Në vitin 2008, KRPP-ja gjeti në një raport mbikëqyrës për Komunën e Prishtinës se ky institucion shkeli ligjin, duke e pranuar në garë këtë kompani, ani pse nuk posedonte garancionin prej 90 ditësh të tenderit.

Kjo kompani është kontraktore edhe e Komunës së Gjakovës, Prizrenit e Ferizajt.

**66. “Gekos”,** pronë e Enver Maliqit dhe Driton Shukit, e që për person kontaktues ka Milaim Bejtën, në vitin 2011-2012 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderë dhe hise në tenderë, duke qenë pjesë e konzorciumeve, që peshojnë bashkë 700 mijë euro.

“Gekoss” bashkë me kompaninë “Dukagjini” u patën dënuar në vitin 2010 nga Komisioni Kosovar i Konkurrencës për krijimin e monopolit të kundërligjshëm në shitjen e arkave fiskale.

**67. “Gërguri”,** kompani në pronësi të Remzi e Hamdi Gërgurit, është hisenike në dy tenderë të Komunës së Prishtinës për ndërtimin e sheshit “Zahir Pajaziti” dhe për furnizim me pllaka për sheshin “Ibrahim Rugova”. Në këta tender është në konzorcium me kompanitë “All Zone” dhe “Zyken Tran”, derisa dy tenderët e kalojnë vlerën prej 7 milionë eurosh.

Kjo kompani ishte shpallur në fillim të viti 2012 edhe fituese e tenderit për shitjen e thëngjillit nga KEK-u, por që ishte ankesa e kompanisë “OVE Group”, kompani e ndërlidhur me familjen e Kryeministri Hashim Thaçi, e cila ia pamundësoi që të nënshkruajë këtë kontratë, derisa tenderi u prish përfundimisht.

**68. “Gerlica Company”,** pronë e Ahmet e Mifal Vogliqi nga Ferizaj, në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 ka marrë tre tenderë në vlerë prej 657 mijë eurosh. Në vitin 2011 ishte kontraktuar nga Komuna e Ferizajt që të shtrojë rrugët e këtij qyteti me kubëza, me një kontratë prej 48 mijë eurosh, Edhe një vit

më parë ajo nga e njëjta komunë ishte kontraktuar për një sërë punësh, që bashkë e kalojnë vlerën prej 130 mijë eurosh.

**69. N.N.SH. "GJASHTË VËLLEZËRIT BATATINA"**, pronë e Tahir Batatina, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011 është kontraktuar për "Punimi, furnizimi dhe montimi i grilave, kapakëve dhe pastrimi e debllokimi i ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik", kontratë që peshon 38 mijë euro.

Në vitin 2012 këtë kompani e ka kontraktuar Komuna e Rahovecit për rregullimin e një kanalizimi, kontratë që peshon 57 mijë euro.

**70. "Global ING"**, pronë e Osman Kajtazit nga Komuna e Prishtinës në konzorcium me "Ideal Projekt" dhe "Vaakal" ka marrë hise nga dy tenderë të vitit 2012 që së bashku peshojnë 75 mijë euro. Kjo kompani është edhe kontraktore e KEK-ut.

**71. "Gollaku"** kompani nga Prishtina, të cilës kompani, Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2012 ka marrë një llot të tenderit "Dhënia me qira e vend gjuetive Prishtina I, II dhe III-në Komunën e Prishtinës". Pos kësaj kompani, për shfrytëzimin e këtij aseti publik, vend-gjuetive, janë shpërblyer edhe kompania "Fazani", që për pronarë ka disa persona: Xhevdet Rexhepi, Ilaz Rexhepi, Hartëig Menne dhe Hashim Rexhepi, por për këtë hise i është dhënë edhe biznesmenit Ragip Mustafa, me kompaninë "Olti Trasing".

**72. "Grafoloni"**, kompani në pronësi të Nazim Pirevës, në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës ka marr tenderin "Furnizimi me material didaktik për shkollë" që peshon mbi 35 mijë euro. Kjo kompani në vitin 2012 ka marrë edhe një tender për furnizim me tonerë të QKUK-së.

**73. „HIB PETROL" SH.P.K.**, pronë e Ibrahim Bucaliut nga Ferizaj, për tri vite, 2008-2011, është gjetur nga Preportr se është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës, vetëm me tenderët e mëdhenj, për furnizim me naftë në vlerë mbi 2 milionë euro.

Kjo kompani është kontraktore e një sërë institucionesh, qendrore dhe lokale, dhe po ashtu depot e saj janë kontraktuar nga Dogana e Kosovës për t'u shfrytëzuar për ankande të mallrave të konfiskuara.

**74. "Hidroing DK"**, në pronësi të Luljete Morinës, nga viti 2009-2012 nga Komuna e Prishtinës ka marrë punë për hartim të projekteve në vlerë prej afro 390 mijë euro.

Kjo kompani, për plane rregullative, është kontraktuar edhe nga disa komuna të Kosovës.

**75. "Hidroplan"** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2012 tenderin prej mbi 3 mijë eurosh "Projektimi i kanalizimit Bardhosh, Lebanë dhe Prugovc".

**76. N.P.N. " HIDROTERM" SH.P.K.**, pronë e Kryetarit të Suharekës, Blerim Kuçi, nga komuna e Isa Mustafës në vitin 2011, në konzorcium me kompaninë "Unicom", pronë e Muharrem Elshani, ka marrë tenderin "Ndërtimi i rrugës "B"-faza e dytë", I vlefshëm mbi 2.8 milionë euro.

Kjo kompani është kontraktore edhe e një sërë institucionesh të qeverisjes qendrore e lokale, por edhe kontraktorë i projekteve të financuara nga fondet e BE-së, siç është Pallati i rejtësisë, ndërtimi i të cilit është kontraktuar të jetë mbi 28 milionë euro, dhe ku Kryetari i Suharekës, Blerim Kuçi ka një hise të tenderit.

Kuçi vazhdon të bëjë biznes, edhe për kundër legjislacionit kosovar në fuqi, që ndalon zyrtarët të jenë aktiv në biznese private, e edhe përkundër faktit që është i dënuar, dhe ka mbajtur një muaj burg, për informim të gjykatës, i thirrur të dëshmojë nga Prokuroria e EULEX-it në rastin e njohur si “Kleçka” kundër deputetit të PDK-së, Fatmir Limaj.

Preportr ka gjetur se në kohën sa MTPT-në po e drejtonte Fatmir Limaj, Blerim Kuçi pati marrë tenderë në vlerë afro gjysmë milioni euro.

Blerim Kuçi kishte qenë pjesë e LDK-së, që nga paraluftra, ku edhe në luftën e fundit ishte ndër të arrestuarit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Për një kohë ka qenë i angazhuar nga ish-kreu i LDK-së, dhe ish-presidenti, Fatmir Sejdiu që të bëjë reforma brenda kësaj partie, por pasi që kishte pranua që nuk ia ka dalë me punën që i ishte ngarkuar, bëri transfero në AAK-në e Ramush Haradinajt, ku është ende pjesë e saj.

**77. “Hyundai Auto”,** pronë e Agim Shabani dhe HYUNDAI AUTO ZAGREB "d.o.o, në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar që për furnizimin me njëzet automjete, tender që peshon 236 mijë euro. Kjo kompani është kontraktore edhe në institucione tjera.

**78. “Ingjinieringu”,** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2012, 2 tenderë në vlerë afro 250 mijë euro. Çuditërisht, ashtu siç është publikuar në njoftimet e Komunës së Prishtinës, “Ingjinieringu”, një kompani e tillë nuk ekziston në ARBK.

**79. “Intech”,** pronë e Sabedin Jashanica, që për person të autorizuar në tender ka Bardh Hoxhën, në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin “Hartimi i planit rregullativ “Prishtina e Re”-Zona Qendër”, punë prej 108 mijë eurosh. Kjo kompani është kontraktore edhe e disa komunave të Kosovës për hartim të planeve.

**80.** Dy biznese, “**Intereminex**”, pronë e Emin, Izet, Mehmet dhe Xhevdet Limani dhe marketi “**Viva**”, vitin që shkoi janë kontraktuar nga Komuna e Prishtinës si dy vende ku punëtorët e komunës, për festat e fundviti, mund të furnizohen aty deri në 100 euro.

**81. N.N.SH. " ISARS "**, pronë e Rrahim Hoxha, ka marrë nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 tenderin “Ndërtimi i sallës të edukatës fizike në shkollën”Hajvalia 2”, që peshon mbi 190 mijë euro.

**82. “Izolimi”,** kompani nga Prishtina, të cilës kompani, Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2012, 2 tenderë. Një prej gjysmë milioni euro, për “Ndërtimi i aneksit të shkollës “Naim Frashëri”, e ka marrë si kompani e vetme, kurse tenderin “Ndërtimi i shkollës së gjelbër në Prishtinë” e ka marrë në konzorcium me kompaninë “Al Trade”.

**83. “Jaha Company”,** pronë e Jahir Hoxhës, në komunën e Prishtinës ka marrë hise nga dy tenderë, në tenderin prej 72 mijë eurosh “Pastrimi i shtratit ,portave të lumenjve dhe i kolektorit atmosferik:, dhe tenderin “Rregullimi i vend ndaljeve të autobusëve”, që peshon 100 mijë euro. Të dy tenderët i ka marrë në konzorcium me kompaninë “Ndërtimtari” nga Podujeva.

**84. “Jame”,** pronë e Jakup Mehmetit nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderin “Mirëmbajtja e semaforëve, inventoreve dhe pajimeve akustike për të verbrit në qytetin e Prishtinës “, i vlefshëm 83 mijë euro.

**85. “Jeta”,** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë ka marrë në vitin 2007, tenderin “Ndërtimi i shkollës nga II.1), sipas kërkesave të specifikimeve teknike të dhëna në dosjen e tenderit”, që peshon 215 mijë euro.

**86. “KAG Asphalt Company”,** pronë e Bashkim, Esat, Gzim, Daut, Reshat dhe Sadat Gashi nga Prizreni, në vitin 2010 nga Komuna e Prishtinës ka marrë 2 tenderë në vlerë prej 2.3 milionë euro.

Kjo kompani është kontraktore e institucioneve që drejtojnë njerëzit e PDK-së. Në vitin 2008, kur MTPT-në e drejtonte Fatmir Limaj, kjo kompani morri tender nga kjo ministri në vlerë mbi 8 milionë euro.

**87. “Kastrioti”,** pronë e Kastriot Fazlija nga Shtimja, në Komunën e Prishtinës në vitet 2011-2012 ka marrë hise nga katër tender, duke qenë pjesë e konzorciumeve, vlera e të cilëve peshon mbi 3.6 milionë euro. Këta tender i ka marrë në konzorcium, veç e veç me **“Ledi Ing”** nga Shtimja dhe **“Arhiko”**.

Kastriot Fazlija e që për PDK-në dha 1 mijë euro donacion në vitin 2010, nga MTPT-ja ka marrë një tender prej mbi 620 mijë eurosh. Por kjo kompani ka marrë një sërë tenderësh në komunën nga vjen, komunën e Shtimes, ku pronari i saj ka marrë pjesë edhe në hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik të kësaj komune.

Në vitin 2009 mori tre tenderë të ndryshëm në Shtime, vlera e të cilëve së bashku ishte 146 mijë euro. Kësaj kompani i ishte dhënë nga Komisioni për Miniera dhe Minerale një licencë për eksploitim të zhavorrit në vitin 2002 -2005. Licenca si kompani ndërtimore i ishte pezulluar për 6 muaj, që nga shtatori 2008.

Kompania “Kastrioti” është edhe hua-dhënëse e deputetit të PDK-së, Ramiz Lladrovci. Sipas deklarami të pasurisë së këtij të fundit, ai i ka borxh 90 mijë euro “Kastrioti” nga Shtimja dhe qëllimi i këtij huazimi është blerja e tokës.

**88. “KEIS (Kosova Pharmaceutical)”**, pronë e Shkelqim Kabashi, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2009 ka marrë tenderin “Furnizimi me aparature mjekësore –analizator dhe EKG”, i vlefshëm 96 mijë euro.

**89. “KGT”,** pronë e Tomë Gashit, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011-2012 ka marrë tender në vlerë prej 77 mijë eurosh. Natyra e furnizimeve të kësaj kompanie për Komunën e Prishtinës është: material higjienik dhe didaktik për institucionet arsimore.

**90. "Kompania Prishtina"**, pronë e Arben, Bekim dhe Rizah Azemi, nga Komuna e Prishtinës ka marr tenderin "Ndërtimi i aneksit të shkollës "Nexhmi Mustafa" në Besi" I vlefshëm prej mbi 220 mijë euro, këtë tender e ka fituar në konzorcium me kompaninë "Kujtimi" dhe "Bini".

Në vitin 2012 kjo kompani u kontraktua edhe nga QKUK-ja për një tender mbi 660 mijë euro; një tender prej 35 mijë eurosh nga Ministria e Drejtësisë, dhe një sërë tenderësh nga Komuna e Podujevës.

**91. "Konstruktori ING 1969"**, pronë e Shaip Shabanit në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për tenderin "Renovimi i bodrumit dhe katit në objektin Komunal", që peshon afro 100 mijë euro. Kjo kompani ka marrë punë për qindra mijëra euro edhe nga Komuna e Podujevës.

**92. "Kosova ERH"**, pronë e Enver Hoti nga Malisheva ka marrë në Komunën e Prishtinës, në Konzorcium me kompaninë "Beni Construction" nga Vitia, tenderin "Ndërtimi i shkollës fillore në Hajvali", që peshon mbi 900 mijë euro.

Kjo kompani ka marrë qindra-mijëra euro tender publikë nga komuna e Prizrenit dhe Malishevës, të dyja këto institucione të drejtuara nga njerëz të PDK-së.

**93. "KosovaMed"**, pronë e Kastriot Asllanit nga Gjakova në vitin 2009 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderin për blerjen e aparaturave shëndetësore, që peshon 113 mijë euro. Kjo kompani është kontraktore edhe e Ministrisë së Shëndetësisë.

**94. "Krapicom"**, pronë e Faik Krapit, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2008 ka përfituar tenderin "Ndërtimi i objektit të gjimnazit "Xhevdet Doda". Ky projekt i ka kushtuar komunës 1.4 milionë euro. Kjo kompani është kontraktore edhe e MASHT-it, Komunës së Gjilanit e të Ferizajt, institucione këto të udhëhequra nga njerëz të PDK-së.

Nga MASHT-i kjo kompani ka marrë tenderë në vlerë prej 6.3 milionë eurosh.

**95. "Kujtimi"**, kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, në vitin 2011-2012 nga kjo komunë ka marrë tenderë dhe hise nëpër tenderë, si pjesë e konzorciumeve që kapin vlerën mbi 600 mijë euro.

**96. "La Semaforica"**, kompani nga Italia, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, në vitin 2011-2012, në konzorcium me kompaninë **"Ekoinvest"**, dhe në një tjetër tenderë, me "Botek", nga kjo komunë ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 460 mijë euro.

**97. "Labi"**, kompani nga Prishtina, pronë e Labinot Buqaj, në vitet 2009-2012 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderë në vlerë mbi 1.3 milionë euro. "Labi" nga KEK-u në vitin 2007 ka përfituar dy tenderë për punë, të cilët së bashku peshojnë mbi 1 milion euro. Kurse nga MASHT ka marrë një tender prej mbi 800 mijë eurosh.

**98. "Ledi Ing"**, pronë e Elveri e Ismet Fazlija nga Shtimja ka marrë dy tenderë nga Komuna e Prishtinës, në konzorcium me kompaninë "Kastrioti" nga Shtimja, pronë e Kastriot Fazlija, vlera e të cilëve arrin në 1.2 milionë euro.

**99. "Link Media Plus"**, pronë e Arbresha Shala dhe Gjorgji Vukov, në vitin 2011 morën 34 mijë euro për tenderin "Stolisja e qytetit për festat e fundvitit".

**100. "Liridoni"**, kompani nga Ferizaj, pronë e Ekrem Esati ka marrë në vitin 2010, si kompani e vetme dhe hise, si pjesë e konzorciumeve, tenderë në vlerë prej 2.3 milionë euro. Tenderin "Ndërtimi i Bibliotekës të qytetit", që peshon 1.5 milionë euro e morën bashkë me kompaninë "Bini" nga Podujeva, derisa ndërtimin e shkollës së Hajvalisë e kishte marrë përsipër vetëm kjo kompani, tender mbi 800 mijë euro. Në vitin 2010 auditorët gjetën se kësaj kompanie, deri sa kishte kryer veç 53% të punëve në shkollën e Hajvalisë, iu kishin paguar mbi 70 e pagesave të një kontrate.

Kjo kompani, nga MASHT-i i kohës së Enver Hoxhajt ka marrë tenderë në vlerë mbi 9.7 milionë euro.

**101. "Luani"**, kompani e sigurimit fizik, në vitin 2011 u kontraktua nga Komuna e Prishtinës për "Sigurimin fizik të objekteve të Qendrave të Mjekësisë Familjare në Prishtinë", ku një roje sigurimi do të paguhej me 1.60 euro në orë.

**102. "Made Kos"**, pronë e Bedri Buzuku nga Prishtina në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar për "Furnizimi me një aparat rentgeni digjital për Qendrën e Mjekësisë Familjare Nr. IV", që peshon mbi 120 mijë euro. Po këtë vit kishte marrë një tender nga MSh-ja prej 57 mijë eurosh, si dhe një kontratë të vogël në Komunën e Kamenicës.

**103. "Malesija"**, pronë e Zefë Malësija nga Istogu në vitin 2011 në Komunën e Prishtinës është shpërblyer me një tender prej 30 mijë eurosh për "Punimi, furnizimi dhe montimin e shenjave të komunikacionit në rrugët e qytetit".

Kjo kompani në vitin 2008, nga MTPT-ja nën drejtimin e Fatmir Limajt ka marrë tenderë publikë në vlerë prej 6.7 milionë eurosh.

**104. "Med Brand"**, pronë e Shkelqim Verdhës nga Prishtina në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar për tenderin "Furnizimi me pajisje mjekësore –Aparat Mamografik dhe ultratingull gjinekologjik 3D për nevojat e QKMF.", që peshon mbi 60 mijë euro.

**105. "Megi Bau"**, pronë e Driton e Fahri Deshishkut, familjarë të deputetit të LDK-së, Hashim Deshishku, që është njëherit edhe pronar i kompanisë "Lesna", ka marrë në Komunën e Prishtinës që drejtohet nga lideri i LDK-së, Isa Mustafa, tender në vlerë prej 670 mijë eurosh. Kjo kompani në vitin 2008, ishte angazhuar nga KEK-u për largimin e djerrinës, punë që KEK-ut i kushtoi mbi 1.3 milionë euro, si dhe një sërë tenderësh të tjerë, qindra mijëra euro. Kjo kompani vazhdon të marrë tender nga sektori i energjisë, në KEK dhe KOSTT.

**106. "Mercom Company"**, pronë e Arif Elshanit në vitin 2011 për një tender prej 50 mijë eurosh ishte angazhuar nga Komuna e Prishtinës për "Furnizim me dy automjete për bartjen e pacientëve në hemodializë". Në vitin 2012 edhe Ministria e sapo formuar e Diasporës, është furnizuar nga kjo kompani me vetura, tender që peshon mbi 51 mijë euro, pastaj nga Komuna e Drenasit, është kontraktuar për furnizim me vetura në vlerë prej 33 mijë eurosh, nga Komuna e Gjilanit iu dha një kontratë e njëjtë prej 74 mijë eurosh, shërbimi korrektues i Kosovës, kontratë mbi 115 mijë euro etj.

Në vitin 2008, Aeroporti i Prishtinës e pati kontraktuar këtë kompani për furnizimi me vetura, kontratë e vlefshme mbi 540 mijë euro.

Nga MASHT kjo kompani ka marrë tenderë në vlerë mbi 3 milionë euro.

**107. “Metali”,** nga Vitia, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar emrin e personit kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2011 është shpërblyer me tenderin “Furnizimi me inventar për Shkolla dhe Institucione parashkollore”, që peshon afro 140 mijë euro. Në hulumtimin 100 milionë, Preportr ka gjetur se një kompani me emrin “Metali”, nga Vitia, e që për pronar ka Elbasan Alidemën, është financuese e PDK-së.

Kjo kompani, që për PDK-në në të dy fushatat e fundit ka dhënë 2 mijë euro, nga MASHT ka fituar një tender mbi 530 mijë euro. Në vitin 2010 kjo kompani nga komuna e Kaçanikut, që udhëhiqet nga Xhabir Zharku i PDK-së ka angazhuar si kontraktor këtë kompani në 4 furnizime me mobile e inventar në vlerë mbi 14 mijë euro.

Në vitin 2011 Gjilani i kishte dhënë tre tenderë, vlera e të cilëve së bashku arrin në 20 mijë euro. Me Gjilanin, “Metali” kishte pasur edhe në vitin 2010 tri kontrata, vlera e të cilave është mbi 33 mijë euro së bashku. Po, komuna e Gjilanit, komunë e PDK-së nuk e kishte lënë “Metalin” vetëm me “tenderë të vegjël”. Në vitin 2011, në tenderin : Lidhja e marrëveshjes së partneritetit publiko – privat, ku përmes bashkimit të punës dhe mjeteve dhe kapitalit do të bashkëveprohet në ndërtim, mirëmbajtje dhe menaxhim të N.P. “HIGJIENA” sh.a. Gjilan – procedurë dyfazëshe të negociuar të tenderit”, përveç “Sh.p.k. “ ECOVISION” Gjilan & “MOSER GROUP”-Austri, është kualifikuar edhe NTP “METALI” Pozhoran. Për këtë kompani institucionet kanë bërë edhe shkelje të ligjit. “Gjatë auditimit tonë kemi vërejtur se projekti ishte i ndarë në disa shpenzime më të vogla se EUR 10,000. Komuna ka bërë kontrata të veçanta dhe pagesa kompanisë NTP Metali gjatë vitit 2008. Ne kemi identifikuar katër pagesa të veçanta të bëra për këtë kompani në shumën prej EUR 505, EUR 6,006; EUR 3,350 dhe EUR 8,345 me një total prej EUR 18,286. Më tutje, komuna duhet të kishte botuar në gazetë tenderin, siç kërkohet me Ligjin për Prokurimin Publik dhe në këtë mënyrë do të kishte shmangur favorizimin e një furnizuesi të vetëm. Komuna nuk ka bërë publike tenderin në gazetë ashtu siç kërkohet me ligjin e prokurimit”, thuhet në raportin e ZAP për vitin 2008, për komunën e Kamenicës.

Një vit më vonë, në vitin 2009, sipas ZAP komuna e Novobërdës kishte shkelur dy herë LPP-në për “Metalin” në tenderin me furnizimin me material ngrohës: dru dhe thëngjill. Në vitin 2010, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave (KMDK), kishte bërë shkelje të vazhdueshme në tenderin për furnizim me makineri të rëndë, ku shpallej fitues “metali”, por ankohej financuesi tjetër i PDK-së, “Getoari” nga Prizreni. Për këtë tender, vlera e të cilit ishte afro 400 mijë euro, ishin zhvilluar disa seanca në OSHP dhe ishte raportuar edhe në media. Pos kësaj shume, prej afro 400 mijë eurosh që i dha më 2010, KMDK-ja këtë kompani e ka shpërblyer edhe në vitin 2011 me tenderin “Furnizim me Kamion Kiper”, vlera e të cilit është 128 mijë euro.

**108. “MGA”,** pronë e Ahmet Govori në vitin 2009, në konzorcium me kompaninë “AEE”, pronë e Daut Krasniqi, Admir Jashari ka marrë tenderin “Furnizimi me gjenerator për shkolla dhe QMF-te të Prishtinës”, që peshon mbi 100 mijë euro.

**109. "Monten",** pronë e Nexhmi Kastratit në vitin 2011 ka marrë një tender të vogël, prej 2600 eurosh nga Komuna e Prishtinës. KRPP-ja për këtë kompani i kishte dhënë vërejtje kësaj komune në vitin 2008, pasi që të njëjtës i ishin pranuar dokumentet dhe shpërblyer me një tender afro 400 mijë euro, ani pse nuk i kishte të plotësuar ato siç kërkonte ligji.

**110. "MSS " MOBILE SANITARY SERVICES " SH.P.K.,** pronë e ADCO International GmbH dhe Behxhet Haxholli, në vitin 2011-2012 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderë në vlerë mbi 320 mijë euro.

Gjatë vitit 2009, bazë të një marrëveshjeje, kontratë, ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe MSS "Mobile Sanitary Services", 12 shërbyes civilë që kanë qenë të angazhuar në mbajtjen e pastërtisë në objektin e komunës kanë kaluar në këtë të fundit.

**111. "Ndërtimtari",** është një biznes i cili ka marrë një sërë tenderësh, dhe është pjesë e konzorciumeve të ndryshme ku vlera e përbashkët e tenderëve që kjo kompani ka përfituar është afro 2.4 milionë euro. Komuna e Prishtinës nuk ka pranuar të bëjë të ditur person me të cilin kontakton, në kuadër të realizimit të projekteve që ka kontraktuar këtë kompani, por Preportri ka përafuar si të mundshëm, edhe pse në ARBK janë me dëgjësia "Ndërtimtari", biznesin "" NDËRTIMTARI " SH.P.K." në të cilin ja në shënuar shumë pronarë (Nezir Shalaku, Kadri Bunjaku, Azem Ujkani, Isuf Berisha, Kurtesh Hyseni, Afrim Krasniqi, Esat Gërvalla, Shefqet Tahiri, Hetem Sinani, Nuhi Mehanja, Mehdi Nasufi, Muhamet Maxhuni, Gani Maxhuni, Ferki Mehmeti, Agim Rama, Ali Mehmeti, Sheqir Brajshori, Elmi Osmani, Fatime Braha, Muhamed Ibrahim, Ahmet Gashi, Hasan Nasufi, Hysni Shabani, Feride Grajçevci, Qamil Fejzullahu, Xhafer Musolli, Hasnija Beqiri, Sabri Sogojeva, Gani Mehuka, Ejup Caka, Zejnulla Mehmeti, Azem Zhegrova, Igballe Miftari, Sadik Hasani, Servet Hajredinaj, Azem Batatina, Ismet Zeneli, Osman Haxhaj, Miradije Lakna, Musa Smajlaj, Arsim Pllana).

Në vitin 2008 ZAP gjeti se bash në tenderin për ndërtimin e objekti të ri të Komunës së Prishtinës, ky institucion kontraktoi një kompani të papërgjegjshme. "OE (Ndërtimtari) fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm, ngase nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. Operatorit fitues i ka munguar raporti i auditimit dhe ka ofruar vetëm pasqyrat financiare të nënshkruara nga një auditor.. Ky kriter ka qenë një ndër arsytet e eliminimit të operatorit ekonomik më të lirë prej €351,201. Punimet fillestare në objekt gjatë 13 ditëve të para janë zhvilluar pa praninë e organit mbikëqyrës", konstaton ZAP.

**112. "Nente Vellezerit",** pronë e Tefik Tullari, nga Komuna e Prishtinës prej vitit 2010-2012 ka marrë tenderë publikë në vlerë mbi 1.8 milionë euro.

**113. ""NIC HOLDING" SH.P.K.,** pronë e Naser Kelmendi, nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar në vitin 2007 për tenderin "Furnizimi me lëndë djegëse – naftë për shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prishtinës", që peshonte 680 mijë euro.

Kjo kompani, sipas ZAP, në një raport të viti 2006 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe dhe kompania "Hyundai Auto Kosova" janë të të njëjtit pronar, ani pse në regjistrimin e fundit në ARBK tash pronarët e këtyre kompanive kanë veç mbiemrat e njëjtë. Në këtë vit ZAP zuri kurdisje çmimesh nga këto dy kompani, të cilat, që të dyja janë kontraktorë të Komunës së Prishtinës, dhe së bashku nga kjo



komunë kanë marrë tenderë në vlerë mbi 920 mijë euro.. “Dosja me nr. të prokurimit 06/015/121 (Furnizim me dy Autoambulanca ) gjatë verifikimit kemi hasur që komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar se tri oferta ( “Nic Holding” , “Hyndai Auto Kosova” dhe “ Solid Kompany”) janë të përgjegjshme prej 7 sa kanë ofertuar, ndërsa prej tri të përgjegjshmeve “Nic Holding” dhe “Hyndai Auto Kosova” janë i të njëjtit pronar ku “Hyndai Auto Kosova” është e inkorporuar në kompaninë “Nic Holding” ( “Nic Holding” ka ofertuar për dy autoambulancat me çmim 49.781€, ndërsa “Hyndai Auto Kosova” 55.500€), dhe fitues është zgjedhur O.E “Nic Holding” ku e ka nënshkruar kontratën me 24.11.2006 në vlerë 49.781€”, thuhet në raportin e ZAP për vitin 2006 për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

114. “NNK Prishtina”, kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, por që në një regjistër të Odës Ekonomike të Kosovës del të jetë **Adem Berisha** , në vitin 2012 nga kjo komunë është shpërblyer me tenderin ‘Meremetimi i shkollës së vjetër në Mat -adaptimi në institucion parashkollor”, kontratë që peshon mbi 110 mijë euro. Kjo kompani ka marrë tender në vlerë mbi 300 mijë euro edhe nga Komuna e Graçanicës, dhe një tender nga Komuna e Shtimes.

**115. “NORËEGIAN PX KOSOVË” SH.P.K.”**, pronë e Gazmend Abrashit, që është pronar edhe i 10 bizneseve të tjera, duke përfshirë edhe rrjetin e supermarketeve “MAXI”, në vitin 2008 nga Komuna e Prishtinës është kontraktura për tenderin ‘Ndërtimi me koncesion i kompleksit miks në Kodrën e Diellit 1 në Prishtinë”. Çuditërisht, tenderi nuk është i ndarë me përqindje, se sa do t’i takonin sektorit publik sa atij privat, Abrashit në këtë rast, por është dhënë një vlerë për metër katrorë.

‘Koha Ditore’ ka shkruar në vitin 2012 se Ukë Rugova, Astrit Haraqija, Gazmend Abrashi dhe Naser Osmani , dy prej tyre funksionarë të lartë të LDK-së, kurse Uka si i bir i ish-Presidentit dhe themeluesit të LDK-së, kanë qenë sekserë për kërkimin e përqindjes së korrupsionit në privatizime në emër të ish-kryetarit të bordit të AKP-së, tash i ndjeri Dino Asanaj, që e përfundoi jetën, sipas prokurorisë, me vetëvrasje.

Me këtë kompani, ‘NORËEGIAN PX KOSOVË’, Abrashi në vitin 2009, sipas të dhënave në hulumtimin e Preportr “Armatura e SHIK-ut”, ka importuar edhe metale.

**116. “Noti”** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2009-2010 ka marrë tenderë në vlerë mbi 1.4 milionë euro.

Ndërtimi i rreth rrotullimit në lagjen “Arbëria” që i është besuar ‘Noti’ , për të cilin auditorët gjeten se “Raporti për pranim të punëve nuk i përket projektit ndërtimi i rrethrotullimit, por të një projekti tjetër”. Noti ishte futur, bashkë me 8 kompani të tjera, në një listë të Drejtorisë së Infrastrukturës në Komunë e Prishtinës, të cilësuar si “lista e zezë”, por e cila nuk kishte pasur ndikim konkret, pasi që Zyra e prokurimit po vazhdonte ta shpërblente këto kompani.

**117. "Oni Design"** kompani nga Prishtina, të cilës kompani Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2012 është kontraktuar për tenderin "Furnizimi me kamion dhe me makina për kositje te barit dhe largimin e borës, në vlerë prej mbi 30 mijë eurosh.

**118. "N.T.P. „PAJTA"**, pronë Sahit Lepaja, në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin "Furnizimi me material elektrik për shkolla dhe Institucione Parashkollore", i vlefshëm afro 50 mijë euro.

**119. "Papenburg & Adriani"**, pronë e Muhamet Dervishit nga Ferizaj, nga Komuna e Prishtinës prej vitit 2010-2012 ka marrë tenderë në vlerë prej 2.4 milionë eurosh.

Kjo kompani nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt ka marrë afro 8.6 milionë euro tenderë publik, si dhe është kontraktorë edhe i një sërë institucionesh, kryesisht në tenderë të infrastrukturës rrugore.

**220. "Paradiso"**, pronë e Sadije Uka, Luan Shahini, është kompania që për një vlerë prej 1.7 milionë eurosh në vitin 2007, sa Prishtinën po e drejtonte Ismet Beqiri, ishte kontraktuar për tenderin 'Ndërtimi i rrugës "Nënë Tereza" nga Hoteli "liiria" deri te hoteli "Grand"'. Kjo punë u shoqërua me skandale publike, deri te akuzat se pllakat ishin radio-aktive, e deri te zvarritjet e mëdha, ku edhe puna kishte përfunduar tek në fund të viti 2010. Parregullsi në këtë tender madje kishte vërejtur në vitin 2008 edhe KRPP-ja, Departamenti i saj i Mbikëqyrjes.

**221. "Petrol –Oti Slovenija"**, pronë e Nazmi Bytyqi, Tomaž Berločnik, Roman Pirš, Company PETROL,Slovenska energetska druzba d.d , Company"OTI CO"J.S.C.,Prishtina (OTI), nga Komuna e Prishtinës është kontraktuar për furnizim me naftë në vitin 2011-2012, në tenderë që kapin vlerën mbi 450 mijë euro. Kjo kompani është kontraktore edhe e një sërë institucionesh qendrore dhe të pushtetit lokal.

**222. "Pharmachem"** në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për tenderin "Furnizimi me pajisje kabinetike për drejtimin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës për Shkollën e Mesme Teknike "28 Nëntori" në Prishtinë", që peshon 90 mijë euro. Në këtë tender person kontaktues ishte Milaim Bejta.

**223. "ProfesionalAlarm"**, pronë e Hava Latifi, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 është kontraktuar për tenderin "Mirëmbajtja e repetitorit dhe radiolidhjeve të Komunës dhe të shkollave të Prishtinës", që peshon 19 mijë euro.

**224. "Proing"**, pronë e Nebih Plla, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2008 ka përfituar tenderin "Punimi i projektit për rrugën anazore "Unaza Qendrore"- Pjesa Perëndimore.", që peshon 118 mijë euro. Kjo kompani ng MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt në periudhën 2008-2010 ka marrë tenderë në vlerë prej afro 800 mijë eurosh.

**225. "Protec"**, pronë e Drenusha Zajmi – Hoxha nga Prizreni , në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës ka përfituar tenderin "Furnizimi dhe montimi i rafteve për Arkivin Komunal " që peshon 108 mijë euro .

**226. "Qendra Kosovare për strehimin dhe trajnimin e qenve endacak"**, për tenderin "Trajtimi i qenve endacak në Komunën e Prishtinës" në vitin 2011 është paguar nga Komuna e Prishtinës me 47 mijë euro.

**227. "Rexha"**, pronë e Samir Rexha, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011-2012 ka marrë tenderë në vlerë prej 2.8 milionë eurosh. Nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt pati marrë tenderë në vlerë prej 1.1 milionë eurosh.

**228. "Rikon"**, pronë e Sami Makollit, nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 është shpërblyer me tender në vlerë prej 46 mijë eurosh.

**229. "RSM"**, pronë e Agim Kola dhe Blerta Berisha në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderin "Ndërtimi i rrugës "Ahmet Krasniqi"", i vlefshëm mbi 980 mijë euro.

Kjo kompani, të cilën e ka punuar Rexhep Selimi, tash deputet i Vetëvendosjes nga MTPT-ja, kur këtë ministri po e drejton Fatmir Limaj ka marrë afro 10 milionë euro tenderë publikë. Disa nga këta tenderë, kompania "RSM" ("Road Signs & Marking") i ka marrë në konzorciumi me kompaninë "Dreal", e regjistruar në pronësi të gruas së Rexhep Selimit, Shqipe Mehmeti Selimi nga Malisheva e Gjilanit.

**230. "Servus Kosova"**, përfaqësi e "Servus Information and Communication Technologies S.R.L." dhe në pronësi të Mark Vuksani, Visar Emini e Ardian Kelmendi nga Komuna e Prishtinës në vitin 2012 është kontraktura për "Furnizimi me detektorë", kontratë që peshon 50 mijë euro.

**231. "Smart Project"**, pronë e Sabahidin Veseli, në Komunën e Prishtinës, vetëm dhe në konzorcium me "Alfa Ing" ka marrë tenderë në vlerë prej afro 16 mijë eurosh. Për projektin, kjo kompani është kontraktuar edhe nga një sërë institucionesh.

**232. "Spana"**, pronë e Korab Gungës, në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për realizimin e "Projekti i veterinës mobile" që peshon 26 mijë euro.

**233. "Standard"**, pronë e Nebih Zariqit, nga Komuna e Prishtinës, në vitin 2009-2010 është shpërblyer me dy tenderë në vlerë mbi 2.1 milionë euro. Kjo kompani është pajisur me leje edhe në disa pjesë të qytetit për të ndërtuar banesa për shitje. Pronari i saj, Nebih Zariqi për dy mandate ka qenë këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Prishtinës nga radhët e LDK-së, parti që tradicionalisht ka udhëhequr me këtë komunë. Ai është edhe kryetar i Shoqatës së Ndërtimtarëve të Kosovës.

**234. "Strassen Tiefbau"**, pronë e Samija Hajdini nga Ferizaj, në vitin 2010 në Komunën e Prishtinës ka përfituar tenderin "Ndërtimi i rrugës në Vranidoll-lagja Serovc", prej 420 mijë eurosh.

**235. "Studio Links 4"**, pronë e Nafije Gashi në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës u shpërblye me tenderin "Hartimi i projektit detal te enterierit dhe inventarit te bibliotekës se qytetit", projekt afro 5 mijë eurosh.

**236. "Technologies"**, kompani nga Mitrovica, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar personin kontaktues, nga kjo Komunë ka përfituar tenderin "Furnizimi me aparate fotokopjuese për shkolla dhe institucione parashkollore të Komunës së Prishtinës", prej 47 mijë eurosh.

**237. "Tekniku"** kompani nga Gjakova, pronë e Visar, Qemajl, Blendi Lluka, në vitin 2011 nga Komuna e Prishtinës është shpërblyer me tenderin "Furnizimi me kompresor për mbushjen me oksigjen të bombolave të aparatit të frymëmarrjes dhe maska për aparat të frymëmarrjes", që peshon 47 mijë euro.

**238. "N.P.T. " TERMOMONTIMI "**, pronë e Skender Mecinaj nga Komuna e Prishtinës në vitin 2011-2012 ka marrë tenderë në vlerë prej 160 mijë eurosh. Kjo kompani është kontraktore edhe e një sërë institucionesh, kryesisht komunës.

**239. "Toifor"**, Enver dhe Isuf Zymeri, në vitin 2011-2012 është gjetur se ka marrë tenderë nga Komuna e Prishtinës, në vlerë prej mbi 670 mijë eurosh. Këta biznesmen të familjes Zymeri, që në Kompaninë e importit të kafes "Empire" janë ortakë biznesi me djalin e ish-presidentit dhe ish-kryetari të LDK-së, Fatmir Sejdiu, janë edhe hisenik të tenderëve për mirëmbajtje të rrugëve nga Komuna e Prishtinës që nga viti 2007.

Në "Empire" aksione ka pasur edhe Meriton e Teuta Abazi, të afërm të familjes së Sejdiut. Meriton Abazi ka qenë edhe drejtor i gazetës "Prishtina Post".

Ky tender, për mirëmbajtjen e rrugëve, për çdo vit duket "Copy-Paste", pasi që fitohet nga kompani të njëjtat, të lidhura në ortakëri me të bijtë e Fatmir Sejdiut. Kështu në vitin 2007 tenderin e njëjtë e fitoi kompani "V.Z.Company" për 7914 euro dhe kompania "Dardania" për 8870 euro, në një tender që krejt ishte 11,250 euro. Në kompaninë e parë ishte aksionar Isuf Zymeri, që tash është po ashtu si bashkëaksionar në "Toifor", që ka marrë pjesë nga ky tender edhe këtë vit. Një vit më vonë, të njëjtin tender e fitoi kompania "Toifor" e cila mori 92,990 euro për pjesën e parë dhe Ndërmarrja Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi", që është kompani publike, dhe mori pjesën e dytë të tij, apo 86,992 euro. Në vitin 2009, po të njëjtin tender e fiton kompania private "Zahiri", që ka hise edhe në tenderin e sivjetshëm dhe mori dy nga tri pjesët e tij. Për pjesën që e fitoi, ajo u pagua mbi 100 mijë euro, kurse pjesa e tretë e tenderit, që e fitoi kompania publike "Pastrimi", mori 83,836 euro.

Edhe në vitin 2010 ishin bashkuar të tria në një tender, ku që të gjitha kanë marrë pjesë të barabarta nga ai. Pjesën e parë të tenderit e mori kompania Private "Zahiri" dhe do të paguhet 94,530 euro, por si punë do të ketë të mirëmbajë 369,605 m<sup>2</sup>. Pjesën e dytë e mori "Toifor" për 97,850 e do të mirëmbajë 355,810 m<sup>2</sup>. Kurse, edhe këtë vit, 2010, pjesa e tretë e tenderit i takoi kompanisë publike "Pastrimi", por edhe ajo do të paguhet ngjashëm me dy kompanitë private, apo më saktë me 96,800 euro për mirëmbajtjen e hapësirës prej 354,450 m<sup>2</sup>.

Edhe në vitin 2011-dhe 2012 kjo kompani nuk u la pa u shpërblyer me hise nga fondet komunale për mirëmbajtjen e rrugëve.

Edhe pse kompania "Toifor" ishte në listën prej 9 kompanive për të cilat Drejtoria e Infrastrukturës Lokale konstatoi se nuk i kanë përmbushur kontratat në vitin 2008 e 2009, kjo nuk e pengoi që të marrë edhe tre tenderë këtë vit. Komuna e Prishtinës arsyetohet se i intereson veç çmimi që ofrojnë kompanitë dhe kursimi i buxhetit.

Në tendertë e mirëmbajtjes, hise vazhdimisht ka marr kompania **“Zahiri”**, pronë e Sevdail Zahiri, kjo kompani pos nga kjo komunë, ka marrë tender në vlerë afro 550 mijë eurosh edhe nga MTPT-ja.

**240. “Ulpiana”**, kompani nga Prishtina të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar personin kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2012 ka marrë tre tenderë në vlerë prej afro 390 mijë eurosh.

**241. “Unicom”**, pronë e Muharrem Elshanit nga Suhareka ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderë dhe hise në tenderë, duke qenë pjesë konzorciumesh, të cilët kapin vlerën mbi 4.6 milionë euro.

Kjo kompani nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt ka marrë tenderë në vlerë mbi 1.7 milionë euro.

**242. “Urban Plus”**, pronë e Ilir Gjinolli, Ardita Byci-Jakupi dhe Arbenita Ymeri-Rexhepi nga Komuna e Prishtinës në vitin 2009 është kontraktuar për ‘Hartimin e Projektit urboarkitektonik për trojet e banimit individual ne lagjen “Mati 3”. Projekt prej 130 mijë eurosh.

**243. “Vaakal”** kompani nga Podujeva, pronë e Berat Shabanit në vitin 2012 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tenderë, ose hise nga tenderë-duke qenë pjesë konzorciumeve që kapin vlerën prej afro 100 mijë eurosh. Kjo kompani nga MTPT-ja në vitin 2010 ka marrë një tender mbi 270 mijë eurosh, derisa është kontraktor edhe i Komunës së Podujevës për një sërë projektsh.

**244. “Vali AL-PVC”** kompani nga Gjilani, në pronësi të Ahmet Bucolli në Komunën e Prishtinës është shpërblyer me tenderin ‘Fasadimi i objektit të ri Komunal në Lagjen Arbëria.’, projekt prej 720 mijë eurosh. Kjo kompani shpërblehet herë-pas here me tenderë edhe nga Komuna e Gjilanit.

**245. “Varna Komerc”**, pronë e Ragip Lenjanit në vitin 2012 është kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për tenderin “Rregullimi i fontanave dhe krojeve ne qytetin e Prishtinës”, punë që u pagua me mbi 30 mijë euro. Kjo kompani është kontraktore e Komunës së Kamenicës e të Vitisë, si dhe nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt ka marrë një tender prej 240 mijë eurosh.

**246. “Ve Mor”**, kompani nga Peja, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar personin kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2012 është kontraktuar për punën “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Prishtinës”, punë prej 170 mijë eurosh.

**267. “Ëëena”**, pronë e Isni Rukiqit nga Drenasi në vitin 2011-2012 nga Komuna e Prishtinës ka marrë tender publikë në vlerë prej afro 580 mijë eurosh.

Kjo komunë ka vazhduar ta shpërblej këtë kompani, dhe pronarin e saj ishte uzurpatorë i pronës publike, gjendje kjo e konstatuar nga Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit te Prishtinës (IQMQP), por kurrë e mohuar nga inspektorati komunal. Sipas IQPQM Rukqi bëri uzurpim të pronës publike në lagjen “Bregu i Diellit”, vetëm pak metra larg shtatores së Enver Malokut, në rrugën me të njëjtin emër.

Ismet Rukiqi në vitin 2012 është shpallur fajtor nga Gjykata Komunale e Prishtinës për veprën penale të kanosjes dhe është dënuar me 200 euro.

Kjo kompani, nga MTPT-ja e kohës së Fatmir limajt ka marrë tenderë në vlerë mbi 1.2 milionë euro.

**268. “Zhvillimi”**, kompani nga Podujeva, pronë e Brahim Tahiri në Komunën e Prishtinës ka marrë tenderë në vlerë mbi 600 mijë euro.

**269. “Zuka Commerc”**, pronë e Muhadin Zuka në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e Prishtinës , që udhëhiqte nga kreu i LDK-së, Isa Mustafa, me tenderin “Asfaltimi i rrugës Busi Marevc – faza e parë “, që peshon mbi 180 mijë euro.

Nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt, kjo kompani ka marrë tender publik në vlerë mbi 800 mijë euro. Muhadin Zuka është familjar i Florim ZUKës, pronar i Kompanisë “Tali”, që tash ka aktakuzë për korrupsion nga EULEX-i, si pjesë “Grupit Limaj”, në hetimet që patën filluar në vitin 2009, ku janë të akuzuar edhe Fatmir Limaj me vëllezërit Demir e Florim Limaj, shefi i kabinetit të Fatmir Limajt, Endrit Shala, shefi i prokurimit në MTPT, Nexhat Krasniqi dhe Gani Zogaj.

Ndryshe, kompania “Tali” , pronë e Florim Zukës, që për PDK-në në vitin 2009-2010 dha 11 mijë euro donacione, në MTPT për këto dy vite ka marrë 8 tenderë publikë, vlera e të cilëve arrin në 7.8 milionë euro. Gjilani në vitin 2010, për “Talin” kishte dhënë 2 tenderë një në vlerë 400 mijë euro dhe një tjetër në vlerë prej 200 mijë eurosh, kurse në vitin 2011, e shpërbleu me 3 kontrata të tjera, një 74 mijë euro, një tjetër 59 mije dhe të fundit 229 mijë euro. Florim Zuka, pronar i “Talit” ka edhe tri kompani të tjera të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë: “ETI Sh.p.k”., “ETii Roads Construction” SH.P.K. dhe NNT “Tali”.